

RAPORTI VJETOR

AGJENCIA KOMBËTARE E DIASPORËS



AGJENCIA
KOMBËTARE
E DIASPORËS



RAPORTI VJETOR 2021

RAPORTIMI I AKTIVITETEVE TË
ZHVILLUARA DHE PASQYRËS FINANCIARE

DHJETOR 2021





Tabela e Përmbajtjes

HYRJE	6
ARRITJET E VITIT 2021:	7
1. AGJENCIA KOMBËTARE E DIASPORËS	9
1.2. ORGANET DREJTUESE.....	9
1.3.1. KËSHILLI DREJTUES	9
1.3.2. DREJTORI EKZEKUTIV	10
1.4. STRUKTURA ADMINISTRATIVE	10
1.4.1 Drejtoria e Diasporës	10
1.4.2. Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse	11
1.4.3. Njësia e Menaxhimit të Projekteve.....	11
2. USHTRIMI I DETYRAVE FUNKSIONALE	12
2.1. Strategjia Kombëtare e Diasporës 2021-2025.....	12
2.2. Grupi i Koordinatorëve.....	12
2.3. Këshilli Kordinues i Diasporës.....	13
3. KUVENDI MBARËKOMBËTAR I DIASPORËS 2021	15
4. AKTIVITETET E AGJENCISË KOMBËTARE TË DIASPORËS.....	16
4.2. TAKIME ME PROFESIONISTË NË DIASPORË.....	16
4.2.1. Takimi i Mjekësisë në Diasporë, Shkurt 2021.....	16
4.2.2. Takimi i Juristëve në Diasporë, Qershor 2021.	17
4.2.3. Takimi “Dita Ndërkombëtare e Remitancave”, Qershor 2021.....	17
4.2.4. Takimi i “Roli i Diasporës në Integrimin Evropian të Vendit”, Mars 2021.	18
5. AKTIVITETE ME KOMUNITETE SHQIPTARE NË BOTË.....	18
5.1. AKTIVITETE PËR KOMUNITETIN SHQIPTAR NË ITALI.....	19
✓ Hora e Arbëreshëve, Siçili:.....	19
✓ Cerzeto, Kalabri:	20
5.2. AKTIVITETE PËR KOMUNITETIN SHQIPTAR NË GREQI	22
✓ Takimi Gratë në Biznes.....	22
✓ Takim me artistët:.....	23
✓ Takim me studentët.....	23
5.3. AKTIVITETE PËR KOMUNITETIN SHQIPTAR NË KROACI	24
5.4. AKTIVITETE PËR KOMUNITETIN SHQIPTAR NË UKRAINË	25





AGJENCIA KOMBËTARE E DIASPORËS

5.4 AKTIVITET ME KOMUNITETIN SHQIPTAR NË MBRETËRINË E BASHKUAR.....	25
5.5 AKTIVITET ME KOMUNITETIN SHQIPTAR NË TURQI.	26
5.6 AKTIVITET ME KOMUNITETIN SHQIPTAR NË SHBA.....	26
5.7 AKTIVITETI “DITA E DIASPORËS”	27
5.8 AKTIVITETE TË TJERA	27
✓ Festivali “Za Fest”	27
✓ Dokumentari dedikuar ‘Nënë Terezës’	27
✓ Aktivitet për promovimin e albumit të parë muzikor të Grupit Arbëresh “SHEGA”	28
✓ Festivali kulturor Shqipëri-Izrael,	28
✓ Realizimi i videos promovuese “Eja në Shtëpi”	28
✓ Mbështetja e artistit Andrea Rama në realizimin e Festivalit “Tirana International Music Dance Theater Festival - 2”	28
6. OFRIMI I BURSIVE PËR STUDENTËT E HUAJ ME ORIGINË SHQIPTARE	29
7. DATABAZA E STUDENTËVE	29
8. SEKTORI I PROJEKTEVE	30
8.1. Njësia e Menaxhimit të Projekteve është përgjegjëse:	30
8.2. PROJEKTET E PLANIFIKUARA PËR ZBATIM	30
8.2.1. Rrjetëzimi i studentëve të diasporës	30
8.2.2. Fuqizimi i Grave në Diasporë	31
8.2.3. Shërbimet për diasporën pranë Njësive të Vetëqeverisjes Vendore (NJVV)	31
8.2.4. Diaspora Shqiptare në Turqi	31
8.3. KOORDINIM ME DONATORËT E PROJEKTEVE NË REALIZIMIN E OBJEKTIVAVE DHE VEPRIMTARISË SË AKD-SË	31
8.3.1. “Follow up - Workshop” me Agjencia Gjermane për Bashkëpunim dhe Zhvillim (GIZ) në kuadër të projektit PMD dhe nga partnerët lokalë	31
8.3.2. Mundësi angazhimi dhe financimi për studentët shqiptar në Gjermani	32
8.3.3. Agjencia Kombëtare e Diasporës bëhet pjesë e projektit rajonal “Marginal resilience: The circular economy model for the enhancement of territorial vocations”	32
8.3.4. Takim pune në Ministrinë e Brendshme të Kosovës për shkëmbimin e praktikave për Ri-integrimin e Personave të Riatdhesuar	33
8.3.5. Roli i Diasporës në integrimin e vendit në bazë të programit “Angazhimi i Diasporës Shqiptare në Zhvillimin Social dhe Ekonomik të Shqipërisë”	33
8.3.6. Cikli i trajnimeve në kuadër të Programit “Migrim dhe Diasporë”	34
8.4. PRITSHMËRITË PËR TË ARDHMEN	35
9. AKTE, MARRËVESHJE DHE MEMORANDUME	35
9.1. Ligje 35	





AGJENCIA KOMBËTARE E DIASPORËS

9.2. Vendime të Këshillit të Ministrave:	36
9.3. Urdhëra institucionale:	36
9.4. Memorandume bashkëpunimi	36
10. PUBLIKIME	38
10.1. BULETINI I MASAVE TË PLANIT TË VEPRIMIT	38
10.2. REVISTA INFORMATIVE PËR BURSAT PËR DIASPORËN NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË	39
10.3. NEWSLETTER PËR DIASPORËN	39
10.4. MANUAL PËR KRIJIMIN E BAZËS TË TË DHËNAVE SHETËRORE TË STUDENTËVE	39
11. RAPORTIMI I DREJTORISË SË FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHETËSE	39
11.1. Realizimi	41
TABELA E BUXHETIT DHE REALIZIMI (PLAN-FAKT)	42
11.1.1. Shpenzime për Fondin e pagave dhe sigurimeve (llogaria ekonomike 600,601)	42
11.1.2. Shpenzimet Korrente (mallra dhe shërbime, llogaria ekonomike 602)	43
11.1.3. Shpenzime kapitale (llogaria ekonomike 231)	44
11.1.4. Financa	44
11.1.5. Burime Njerëzore	45
11.1.6. Protokolli	46
11.1.7. Magazina	47
11.1.8. Prokurime	47
12. PLANIFIKIMI I AKTIVITETEVE PËR VITIN 2022	48
12.1. Programi vjetor i AKD-së për vitin 2022	48
12.1.1. Aktiviteti vjetor me rastin e Ditës së Diasporës	48
12.1.2. Takimi i Mjekësisë në Diasporë	48
12.1.3. Takimi i Juristëve në Diasporë	48
12.1.4. Programi vjetor për organizimin e shkollës verore “Jam shqiptar”	49
12.1.5. Programi për ofrimin e bursave për studentët e huaj me origjinë Shqiptare	49
12.1.6. Programi vjetor për Komunitetet Shqiptare në Mbretëri e Bashkuar, Itali, Greqi, Turqi, Bullgari, Bruksel, Ukrainë, SH.B.A, Kroaci etj.	49
SFIDA NË TË ARDHMEN	51
PËRMBYLLJE	52





HYRJE

Agjencia Kombëtare e Diasporës është ndër institucionet kryesore shtetërore përgjegjëse për zbatimin e politikës së qeverisë shqiptare në marrëdhëniet e diasporës shqiptare me vëndin e origjinës. Ajo ka për mision nxitjen dhe konsolidimin e bashkëpunimit institucional me komunitetet shqiptare në diasporë, me qëllim zbatimin e një qasjeje gjithëpërfshirëse në zhvillimin ekonomik, politik, social dhe kulturor të Shqipërisë.

Në detyrat kryesore të Agjencisë, të parashikuara në Ligjin nr. 115/2017 “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës”, i ndryshuar është përgatitja e një raporti periodik mbi veprimtarinë vjetore të Agjencisë.

Raporti Vjetor 2021 është një përmbledhje e funksioneve dhe aktiviteteve të realizuara nga Agjencia Kombëtare e Diasporës, kundrejt objektivave kryesorë vjetorë dhe atyre strategjikë. Agjencia Kombëtare e Diasporës gjatë vitit 2021 ka vepruar në përputhje me drejtimin strategjik dhe në një frymë me politikat e Qeverisë Shqiptare në fushën e diasporës.

Raporti shërben për të informuar institucionet përgjegjëse dhe publikun rreth veprimtarisë të Agjencisë gjatë vitit 2021, si dhe prezantimi i programit të aktiviteteve gjatë vitit 2022. Disa prej çështjeve kryesore të trajtuara në raport janë: statusi ligjor i Agjencisë Kombëtare të Diasporës; struktura e institucionit, veprimtaria e institucionit gjatë vitit 2021, aktivitetet institucionale, aktet ligjore bazë për veprimtarinë e AKD si dhe analiza financiare për vitin 2021 e shoqëruar me parashikimet për vitin 2022.

Komisioni European (KE) miratoi Paketën e Zgjerimit 2021 dhe vlerësoi situatën dhe progresin e arritur në vendet e Ballkanit Perëndimor (BP) dhe Turqi në proceset e tyre respektive drejt hyrjes në Bashkimin European.

Në raportin e Komisionit European vlerësohet progresi i kryer në fushën e Diasporës, në tre drejtime kryesore:

Miratimi i Strategjisë Kombëtare të Diasporës 2021-2025;





**AGJENCIA
KOMBËTARE
E DIASPORËS**

Qasjen e diasporës në fushën e shkencës dhe kërkimit;

Në nismën, të ashtëquajturën “qarkullimi i trurit”

Në këtë kuadër krahas gjithë faktorëve të tjerë institucionalë edhe Agjencia Kombëtare e Diasporës ka luajtur rolin e vet në arritjen e kësaj performance pozitive.

ARRITJET E VITIT 2021:

Ndër arritjet e vitit 2021, për Agjencinë Kombëtare të Diasporës janë: implementimi me sukses gjatë vitit të parë i “ Strategjisë Kombëtare të Diasporës dhe të Planit të Veprimit 2021-2025”, digjitalizimi i bazës së të dhënave për studentët shqiptar që jetojnë jashtë vendit nëpërmjet krijimit të Platformës “Databaza e studentëve” me fokus rritjen e ndërveprimit me studentët duke lehtësuar komunikimin mes tyre, “rrjetëzimi” midis ekspertëve, profesionistëve të ndryshëm nga diaspora, si dhe ndryshimet ligjore të diktura kryesisht nga nevojat institucionale, sollën për rrjedhojë draftimin dhe miratimin e Ligjit 35/2021 datë 16.03.2021 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.115/2017 “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës”, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.403, datë 30.06.2021 “Për përcaktimin e rregullave të përgjithshme, kritereve dhe procedurave specifike për marrjen me qira të ambienteve dhe lidhjen e kontratave të veçanta me bashkëpunetorë të jashtëm ose figura të njohura shqiptare në diasporë, të cilat nevojiten të kryhen me qëllim zbatimin dhe realizimin e programit vjetor të Agjencisë Kombëtare të Diasporës dhe që nuk rregullohen nga legjislacioni në fuqi për prokurimin publik”.

Bashkëpunimi ndërmjet AKD dhe shoqatave e organizatave brenda dhe jashtë vendit përfaqësuese të target grupeve të ndryshme të diasporës shqiptare. Vlerësimi i organizatave shqiptare të diasporës dhe politikave të migrimit tregojnë për rolin në rritje që mund të luajë diaspora si një ndërmjetësuese mes vendeve pritëse dhe vendit të origjinës. Organizatat e diasporës shqiptare në Perëndim, po përqendrohen edhe më shumë në mënyrën e organizimit më të mirë të tyre në vendet pritëse dhe përparësitë e tyre të brendshme. Ato po adresojnë situatën e anëtarëve të diasporës, të nevojave dhe kërkesave të tyre të ndërlidhura me pjesëmarrjen politike dhe të drejtat e punëtorëve, shtetësinë dhe të drejtat e komuniteteve fetare.



Hartimi i programeve të veçanta për komunitetet shqiptare më të vjetra si ato të Italisë, Greqisë, Ukrainës, Kroacisë, e Bullgarisë por dhe komuniteteve të Mbretërisë së Bashkuar dhe SH.B.A tashmë janë pjesë e programit vjetor të Agjencisë Kombëtare e Diasporës. Ato janë fillimi i një pune me mjaft sfida pranë komuniteteve shqiptare në diasporë.

Për këtë qëllim, është përdorur një metodologji bashkëkohore e kryqëzuar informacioni duke shfrytëzuar:

- ✓ Zbatim të objektivave që rrjedhin nga implementimi i “Strategjisë Kombëtare të Diasporës 2021-2025” dhe Ligji Nr. 115/2017 “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës” i ndryshuar;
- ✓ realizimi i takimeve me përfaqësues të diasporës shqiptare në vendet pritëse si dhe shoqata e organizata që veprojnë në diasporë.
- ✓ përgatitjes, mbledhjes dhe analizës së pyetësorëve për të tërhequr interesimin e çdo përfaqësuesi të diasporës në aktivitete të zhvilluara gjatë vitit paraardhës;
- ✓ interesat e evidentuara gjatë realizimit të diskutimeve të drejtpërdrejta gjatë aktiviteteve specifike të natyrës së brainstorming të përcjella nga pjesëtarë të diasporës;
- ✓ marrjes së mendimit të të gjitha institucioneve të interesuara për diasporën;
- ✓ konsultave dhe bashkëpunimi me partnerët ndërkombëtarë.



1. AGJENCIA KOMBËTARE E DIASPORËS

Agjencia Kombëtare e Diasporës është person juridik publik, me statusin e "Agjencisë autonome", me seli në Tiranë. Agjencia funksionon në bazë të Ligjit Nr. 115/2017 "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës" i ndryshuar.

1.2. ORGANET DREJTUESE

Në përputhje me pikën 3 të nenit 5 të Ligjit Nr. 115/2017 "Për Krijimin e Agjencisë Kombëtare për Diasporën", i ndryshuar organet drejtuese të Agjencisë janë:

- Këshilli Drejtues
- Drejtori Ekzekutiv

1.3.1. KËSHILLI DREJTUES

Këshilli Drejtues është organi vendimmarrës për çështjet administrative dhe financiare të Agjencisë. Mënyra e organizimit dhe funksionimit, si dhe kompetencat e Këshillit Drejtues rregullohen përmes Ligjit Nr. 115/2017 "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës" si dhe Vendimit Nr. 114/2018 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e rregullave për emërimin, shkarkimin dhe shpërblimin e kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit Drejtues të Agjencisë Kombëtare të Diasporës".

Këshilli Drejtues i Agjencisë Kombëtare të Diasporës përbëhet nga 7 (shtatë) anëtarë, të cilët zgjidhen nga titullarët e Institucioneve të Administratës Publike të parashikuara në nenin 7 të Ligjit Nr.115/2017, i ndryshuar.

Gjatë vitit 2021 Këshilli Drejtues, me propozimin e Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë Kombëtare të Diasporës, ka marrë vendimet poshtëshënuar:

- Vendim Nr.1 datë 31.03.2021 "Për miratimin e buletinit të parë, Mars 2021 të Planit të Veprimit të Masave të Strategjisë Kombëtare të Diasporës 2021-2025".
- Vendim Nr.2 date 31.03.2021 "Për miratimin e planit për detajimin buxhetor 2021"
- Vendim Nr.3 datë 28.06.2021 Për "Miratimin e Programit e Programeve të Agjencisë Kombëtare të Diasporës, për periudhën qershor-dhjetor 2021 dhe miratimin e Rregullores së Këshillit Drejtues të Agjencisë Kombëtare të Diasporës".





1.3.2. DREJTORI EKZEKUTIV

Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë Kombëtare të Diasporës është autoriteti më i lartë ekzekutiv i saj. Ai është përgjegjës për administrimin dhe funksionimin e Agjencisë. Drejtori Ekzekutiv përfaqëson Agjencinë Kombëtare të Diasporës në marrëdhënie me të tretët.

Gjatë vitit 2021, kjo detyrë ushtrohet nga Znj.Sonila Hysi, e cila posedon statusin administrativ, Drejtues i Trupës së Nivelit të lartë Drejtues (TND).

Drejtori Ekzekutiv raporton periodikisht në Këshillin Drejtues për veprimtarinë e Agjencisë Kombëtare të Diasporës.

1.4. STRUKTURA ADMINISTRATIVE

Struktura administrative e Agjencisë Kombëtare të Diasporës është miratuar me Urdhrin e Kryeministrit Nr.111, Datë 10.09.2021 “Për miratimin e Strukturës së Organikës së Agjencisë Kombëtare të Diasporës” dhe përbëhet nga: Drejtoria e Diasporës (Sektori i Diasporës dhe Sektori i Kulturës, Identitetit dhe Komunikimit), Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse si dhe Sektori i Projekteve.

Bazuar në nenin 10, shkronja b), të ligjit 115/2017 “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës”, një nga burimet financiare për realizimin e misionit të Agjencisë Kombëtare të Diasporës, janë të ardhurat nga projekte, donacione dhe burime të tjera të ligjshme.

Për këtë arsye duke qenë se Agjencia Kombëtare e Diasporës, gjatë vitit parardhës nuk kishte një strukturë të dedikuar për angazhimin në projekte, struktura e saj organizative u ristrukturua duke krijuar “Njësinë e menaxhimit të projekteve”, në bazë edhe të legjislacionit të BE-së për krijimin e njësisë së projekteve.

1.4.1 Drejtoria e Diasporës

Drejtoria e Diasporës është përgjegjëse:

- Për koordinimin dhe zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Diasporës dhe Planit të Veprimit të saj;



- Për planifikimin, organizimin dhe zbatimin e detyrimeve të lidhura me qëllimet dhe aktivitetin e Agjencisë.

1.4.2. Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse

Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse është përgjegjëse:


- Për administrimin e buxhetit të miratuar dhe veprimtarinë financiare të Agjencisë;
- Për përgatitjen e projekt-buxhetit dhe për administrimin e çdo çështjeje që lidhet me hartimin e planit financiar buxhetor afatmesëm e vjetor me qëllim arritjen e objektivave të Agjencisë Kombëtare të Diasporës.

1.4.3. Njësia e Menaxhimit të Projekteve

Njësia e Menaxhimit të Projekteve është përgjegjëse:

- Për planifikimin, drejtimin dhe zbatimin e projekteve në përputhje me misionin e institucionit dhe në nxitje të sipërmarrjes së Diasporës për zhvillimin social-ekonomik dhe kulturor.
- Koordinon me donatorët e projekteve në realizimin e objektivave dhe veprimtarisë të Agjencisë Kombëtare të Diasporës për Zhvillimin e Diasporës:

STRUKURA E AGJENCISË KOMBËTARE TË DIASPORËS





2. USHTRIMI I DETYRAVE FUNKSIONALE

2.1.Strategjia Kombëtare e Diasporës 2021-2025

Agjencia Kombëtare e Diasporës, në zbatim të detyrave funksionale të saj, ndjek zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Diasporës dhe Planin e saj të Veprimit.

Në 1 janar 2021 ka hyrë në fuqi Vendimi Nr.585, Datë 22.07.2021 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Diasporës 2021-2025 dhe të Planit të Veprimit”. Kjo është Strategjia e dytë që Qeveria Shqiptare ka miratuar për marrëdhënien me Diasporën Shqiptare. Dy vite më parë u miratua Strategjia Kombëtare e Diasporës 2018 – 2024, e cila ishte i pari dokument në llojin e vet. Zhvillimet dinamike sollën nevojën për rishikimin dhe përditësimin e këtij dokumenti të rëndësishëm për marrëdhënien e Shtetit Shqiptar me Diasporën.

Gjatë vitit 2021, Agjencia Kombëtare e Diasporës ka koordinuar veprimtarinë administrative ndërmjet institucioneve përgjegjëse për zbatimin e Strategjisë, si dhe ka bashkëpunuar me to për realizimin në afat të masave të Planit të Veprimit. Me qëllim zbatimin e parimit të transparencës dhe të drejtës së informimit, Agjencia ka publikuar, çdo 3 (tre) muaj, Buletinin për realizimin e Planit të Veprimit të Strategjisë. Këto buletine janë të depozituara edhe pranë Komisionit për Politikën e Jashtme dhe Nënkomisionit për Diasporën dhe Migracionin.

2.2. Grupi i Koordinatorëve

Në vitin 2021, për zbatimin e Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare për Diasporën 2021-2025, Agjencia Kombëtare e Diasporës ka zhvilluar takime me Grupin e Koordinatorëve, i ngritur me Urdhrin e Kryeministrit “Për përcaktimin e grupit të koordinatorëve për zbatimin e planit të veprimit të strategjisë kombëtare për diasporën 2021-2025”.

Në takimet e mësipërme rëndësi ka marrë konkluzionet për publikimin e Buletineve tre mujore dhe problematikat lidhur me zbatimin e masave të Planit të Veprimit.

Për shkak të masave të ndërmarra si rrjedhojë e pandemisë Covid-19, komunikimi me anëtarët e Grupit është mbajtur kryesisht nëpërmjet platformave virtuale me qëllim vijimësinë e plotësimit të detyrave.





2.3. Këshilli Kordinues i Diasporës

Këshilli Kordinues i Diasporës është organi përfaqësues i marrëdhënieve të Diasporës me institucionet shtetërore shqiptare. Në mbledhjet e tij të rregullta marrin pjesë përfaqësuesit më të lartë të institucioneve shtetërore. Ai është ngritur dhe kryen veprimtarinë e tij mbi bazën e Ligjit Nr. 16/2018 “Për Diasporën” i ndryshuar. Në përputhje me këtë ligj, Agjencia Kombëtare e Diasporës kryen funksionet e sekretariatit teknik të Këshillit Koordinues të Diasporës.

Agjencia koordinon mbledhjet dhe takimet me anëtarët e Këshillit Koordinues të Diasporës. Në vitin 2021, Këshilli Koordinues i Diasporës, ka realizuar disa takime online, për shkak dhe të gjendjes së emergjencës COVID-19.

Gjithsej gjatë vitit 2021 nga Këshilli i Kordinues janë realizuar ____ takime zyrtare:

Me datë 22 Shkurt 2021, nëpërmjet platformës “Zoom”, është zhvilluar takimi online ndërmjet anëtarëve të Këshillit Koordinues të Diasporës, përfaqësuesve të institucioneve kryesore të pushtetit qendror dhe përfaqësuesve të shoqërisë civile, ku fokusi i këtij takimi lidhej me realizimin e të drejtës së votës së diasporës.

Me datë 28 Shkurt 2021, është zhvilluar takimi online nëpërmjet platformës “Zoom”, ndërmjet anëtarëve të Këshillit Kordinues në Diasporë. Qëllimi i takimit të mbajtur ishte “Realizimi i Votës së Diasporës nga KQZ-ja”. Diskutim i hapur me disa anëtarë të KKD-së, të cilët kanë punuar dhe po punojnë për realizimin e të drejtës së votës së diasporës dhe të sigurohen që ky proces të zhvillohet në përputhje me kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi. Gjithashtu takimi kishte fokus të veçantë pjesëmarrjen e KKD-së në takimin që do të zhvillohej nga KQZ-ja në datën 1 mars 2021.

Me datë 9 Gusht 2021, është zhvilluar takimi online ndërmjet Këshillit Kordinues në Diasporë dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës në Kosovë. Qëllimi i takimit të mbajtur ishte prezantimi i KKD-së me Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës të Republikës së Kosovës. Përveç pjesës prezantuese u zhvilluan edhe diskutime konkrete për bashkëpunimin e mëtejshëm të Këshillit me palën Kosovare dhe forcimin e bashkëpunimit së bashku me Qeverinë e Shqipërisë, konkretisht:



AGJENCIA KOMBËTARE E DIASPORËS

- Organizimi i një bashkëpunimi mes Ministrisë së Kosovës dhe Shqipërisë për krijimin e një grupi homogjen për ruajtjen e gjuhës.
- Rishikimi i vendimeve të marra deri tani mes dy qeverive të Shqipërisë dhe Kosovës.
- Organizimi i Samitit, pra me ndryshimin e emrit në “Kuvendi Mbarëkombëtar” që është parashikuar të mbahet në muajin korrik të vitit 2022 në Prishtinë, kërkohet një bashkëpunim për organizimin e tij.
- Qendrat Kulturore në Diasporë.
- Strategjia e re e Diasporës
- Shkëmbimi për çështjet e arsimit dhe Diplomacisë Ekonomike.
- Vota e Diasporës
- Bizneset, rrjetet.

Me datë 7 Nëntor 2021, është zhvilluar takimi online nëpërmjet platformës “Zoom”, ndërmjet anëtarëve të Këshillit Kordinues në Diasporë.

Gjatë takimit on-line u diskutua mbi rolin e rëndësishëm që luan diaspora shqiptare në zhvillimin ekonomik, social, kulturor etj, në vendin e origjinës si dhe u shtruan shqetësimet në lidhje me ecurinë e organizimit të Agjencive (Qendrave) të Diasporës si dhe shkrirjen e Ministër Shteti për Diasporën, mbi të drejtën e Votës për ta bërë efektive të drejtën e ushtrimit të votës nga Diaspora përmes akteve ligjore dhe nënligjore dhe funksionalitetin e sistemit/platformës përkatëse, si dhe mbi modalitetet mbi zhvillimin e mbledhjes së Këshillit Koordinues të Diasporës datë 18 dhjetor 2021, nëse duhet të zhvillohet fizikisht, on line apo varianti hibrid alternativ me prezencë fizike dhe on line.

Me datë 14 Nëntor 2021, është zhvilluar takimi online nëpërmjet platformës “Zoom”, ndërmjet anëtarëve të Këshillit Kordinues në Diasporë. Gjate këtij takimi on line, u krye shtyrje të mbledhjes së Këshillit Koordinues të Diasporës në datë 15 nëntor 2021.

Me datë 15 Nëntor 2021, është zhvilluar takimi online nëpërmjet platformës “Zoom”, ndërmjet anëtarëve të Këshillit Kordinues në Diasporë në të cilën u diskutuan çështjet si më poshtë:

- për kohëzgjatjen e takimit (*sa ditë*);





- ditën e zhvillimit të Takimit të Këshillit Koordinues të Diasporës (*të premtë apo të shtunë*);
- tematikat që do të trajtohen gjatë mbledhjes së KKD datë 18 dhjetor 2021
- modalitetet e zhvillimit fizikisht, on- line, apo varianti hibrid.
- listën e të ftuarëve, krahas (Kryeministri, Presidenti, Ministri, Kryetari i opozitës, Z.Ilirjan Celibashi etj), nëse do këtë të ftuar dhe nga rajoni përkatësisht nga Kosova, Maqedoni e Veriut, Mali i Zi.
- përfaqësimi në KKD dhe pjesëmarrja në mbledhjet e Këshillit.

Me datë 5 dhjetor 2021, është zhvilluar takimi online nëpërmjet platformës “Zoom”, ndërmjet anëtarëve të Këshillit Koordinues të Diasporës, në të cilën u shtruan për diskutim çështjet e poshtëshënuara:

- A është prioritet Diaspora;
- Vota e Diasporës;
- Pozicionimi i strukturave të diasporës me ndryshimet e reja në strukturën Qeverisë;
- Modalitetet e kontaktit për Këshillin Koordinues të Diasporës;
- Mbledhja e Këshillit Koordinues të Diasporës, data në të cilën do të zhvillohet.

3. KUVENDI MBARËKOMBËTAR I DIASPORËS 2021

Në vitin 2021 janë hedhur disa hapa përgatitorë për organizimin e Kuvendit Mbarëkombëtar të Diasporës. Ai do të jetë vijim i organizmit të Samitit të Dytë të Diasporës Shqiptare, i cili u zhvillua në datat 28 shkurt - 2 mars 2019 dhe mikpritësi përfaqësues të komuniteteve shqiptare në mbarë botën.

Kuvendi Mbarëkombëtar i Diasporës është konceptuar ndryshe nga të qenit një aktivitet vetëm i Republikës së Shqipërisë. Kuvendi do të zhvillohet nën drejtimin e Këshillit Koordinues të Diasporës dhe do të kërkojë koordinimi me Republikën e Kosovës dhe Republikën e Maqedonisë së Veriut. Janë në diskutim vështirësitë teknike të mbajtjes së aktivitetit për shkak të masave anticovid.

Gjithashtu është propozuar edhe për krijimin e një urdhëri të përbashkët, i cili ka në përbërje të tij Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe të Diasporës së Kosovës, Ministrin e Jashtëm të Maqedonisë së Veriut si edhe Agjencinë Kombëtare të Diasporës në koordinimin ndër-institucional për organizimin e Kuvendit Mbarëkombëtar të Diasporës.





4. AKTIVITETET E AGJENCISË KOMBËTARE TË DIASPORËS

Agjencia Kombëtare e Diasporës ka ndërtuar një mekanizëm të vlerësimit të nevojave të diasporës i cili ka shtrirje “makro” dhe “mikro” dhe konkludon me miratimin e programit vjetor në Këshillin Drejtues.

Programi është hartuar me kujdes, duke u bazuar në kërkesat e drejtpërdrejta të pjesëtareve të diasporës shqiptare si dhe kërkesave që rrjedhin nga zbatimi i “Strategjisë Kombëtare për Diasporën 2021-2025”.

Edhe pse kushtet specifike globale të krijuara nga pandemia botërore e Covid-19 vështirësuan realizimin e aktiviteteve masive, përsëri AKD arriti të realizojë të gjitha obligimet e saj të programuara në planin vjetor të veprimit duke shfrytëzuar mundësitë që lejonte kjo situatë.

4.2.TAKIME ME PROFESIONISTË NË DIASPORË

4.2.1. Takimi i Mjekësisë në Diasporë, Shkurt 2021

Në datë 21 Shkurt 2021 u zhvillua “Takimi i Mjekësisë në Diasporë”, për të dytin vit radhazi, me pjesëmarrës profesionistët shqiptarë dhe atyre të Diasporës në fushën e mjekësisë.

Në takimin përkatës është diskutuar në lidhje me: “Politikat shtetërore, mjekët shqiptarë në Diasporë dhe roli i rrjetit të profesionistëve”, “COVID-19 – Sfidat, vështirësitë dhe menaxhimi i situatës nga mjekët në vend dhe në Diasporë” si dhe “Vaksina, një lehtësim për sistemin shëndetësor dhe jetën e qytetarëve”.

Duke qenë se viti paraardhës kishte protagonistë kryesor sistemin shëndetësor dhe mjekët në të gjithë botën si pasojë e luftës me COVID-19, mjekët e diasporës kanë luajtur një rol të rëndësishëm në sistemet shëndetësore ku kanë shërbyer.





Takimi i mjekëve në diasporë kishte si qëllim krijimin e rrjetëzimit të mjekëve, infermierëve dhe profesionistëve shqiptarë të mjekësisë kudo në botë, duke u shndërruar në një takim të përvitshëm ku këta profesionistë mblidhen dhe shpalosin idetë e tyre, propozimet për përmirësimin e sistemit të kujdesit shëndetësor në vend si dhe rishikimin e mundësisë së kthimit në Shqipëri përmes politikave shtetërore.

4.2.2. Takimi i Juristëve në Diasporë, Qershor 2021.

Në datë 7 qershor 2021, u zhvillua aktiviteti “Takimi i Juristëve në Diasporë”. Në aktivitetin përkatës është diskutuar në lidhje me angazhimin e juristëve në diasporë dhe ndërveprimin e tyre me juristët në Shqipëri me qëllim shkëmbimin e përvojave dhe praktikave më të mira për adresimin e sfidave aktuale në sistemin e drejtësisë. Kontributi i tyre është i rëndësishëm në vendosjen dhe forcimin e urave lidhëse të bashkëpunimit me institucionet shqiptare si dhe angazhimin e tyre në procese të rëndësishme, si forcimi i kuadrit ligjor shqiptar, dhënia e mendimeve dhe sugjerimeve mbi amendamente të nevojshme të legjislacionit, përshtatjen e legjislacionit shqiptar me Acquis Communautaire etj.

4.2.3. Takimi “Dita Ndërkombëtare e Remitancave”, Qershor 2021.

Në datë 16 Qershor 2021 u zhvillua aktiviteti “Dita Ndërkombëtare e Remitancave”, duke vlerësuar kështu ndikimin dhe rëndësinë e remitancave në zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të vendit, si dhe identifikimin dhe promovimin e politikave, programeve dhe praktikave më të mira të institucioneve financiare në lidhje me forcimin e kontributit të emigrantëve, objektiva kryesorë që parashikohen në Strategjinë Kombëtare të Diasporës.

Varësia e lartë e Shqipërisë tek remitancat kërkon menaxhim strategjik në trajtimin ekonomik të tyre. Ekzistojnë modele suksesi për të ndërthurur në ekonomi të ardhurat e remitancave me burime të tjera zhvillimi, si tregtia apo investimet e huaja të drejtpërdrejta. Orientimi i dërgesave të remitancave drejt mekanizmave formalë rrit transparencën dhe promovon sistemin bankar duke rritur fuqinë e tregut të remitancave.



4.2.4. Takimi i “Roli i Diasporës në Integrimin Evropian të Vendit”, Mars 2021.

Në kuadër të programit “Angazhimi i Diasporës Shqiptare në Zhvillimin Social dhe Ekonomik të Shqipërisë” në takimin “**Roli i Diasporës në Integrimin Evropian të Vendit**”, zhvilluar në datë 08.03.2021 në Tiranë, janë prezantuar nëpërmjet një ceremonie online ekspertët e përzgjedhur që jetojnë në vende të ndryshme jashtë Shqipërisë, të cilët do të kenë rol në integrimin e vendit në BE.

Migrimi ka qenë një temë e rëndësishme e reflektimit të politikave të Bashkimit Evropian gjatë viteve të fundit. Strategjia Evropiane 2021 dhe Programi i Stokholmit pranojnë potencialin e lartë dhe kontributin e madh të migrantëve për BE-në si edhe për ndërtimin e një ekonomie konkurruese dhe të qëndrueshme.

5. AKTIVITETE ME KOMUNITETE SHQIPTARE NË BOTË



Sipas të dhënave nga Peoplenov.in, në Greqi jetojnë 676.847 shqiptarë, ndërsa në Itali 522.647.

Nisur nga të dhënat e prezencës më të lartë të pjesëtarëve të diasporës shqiptare në vendet pritëse dhe rëndësisë historike e kulturore që mbartin, Agjencia gjatë vitit 2021 ka realizuar një sërë aktivitete me komunitetet shqiptare kudo në botë.



5.1. AKTIVITETE PËR KOMUNITETIN SHQIPTAR NË ITALI

Agjencia Kombëtare e Diasporës, në datat 30-31 gusht dhe 1 shtator 2021, zhvilloi aktivitetin *“Tinguj jete midis tokës dhe detit”* me Komunitetin Arbëresh në Itali, në Horën e Arbëreshëve në Siçili dhe në Cerzeto në Kalabri.

Qëllimi i këtij aktiviteti ishte prezantimi i kulturës shqiptare në rajonin ku u zhvillua duke forcuar urat e rëndësishme të marrëdhënieve shqiptare me ato arbëreshe të vendit fqinj si dhe konsolidimi i bashkëpunimit institucional me komunitetin Arbëresh në Itali, me qëllim ruajtjen e gjuhës, vlerave kombëtare dhe kulturore.

✓ **Hora e Arbëreshëve, Siçili:**

Aktiviteti përkoi me 533 vjetorin e themelimit të Hora e Arbëreshëve. Hora e Arbëreshëve (apo siç njihet në gjuhë italiane si Piana degli Albanesi) është komuniteti më i madh arbëresh i vendosur në Itali, në vitin 1488 e që sot numëron mbi 6 mijë banorë. Qyteti ndodhet në krahinën e Palermos dhe ka ruajtur traditën dhe zakonet shqiptare, e flet gjuhën shqipe si gjuhë zyrtare krahas me gjuhen italiane. Aktiviteti u zhvillua në koordinim me përfaqësues të përfaqësisë diplomatike shqiptare në Itali.

U zhvillua vizitë zyrtare në mjediset e bibliotekës, ku ruhen vepra të letërsisë arbëreshe, duke nënvizuar idenë se Hora e Arbëreshëve është vendi ku lindi letërsia arbëreshe, pikërisht ku dhe u shkrua vepra e parë e diasporës me 1592. Ajo është edhe iniciatore e shkollës së parë europiane në vitet e para të shekullit XVI, kur nisi mësimi i gjuhës shqipe.

U zhvillua konferencë me prezantime të Kryetarit të Bashkisë së Piana degli Albanesi Z. Rosario Petta, Drejtoreshës Ekzekutive të AKD Znj. Sonila Hysi, përfaqësues nga Ministria e Brendshme në Siçili, përfaqësues të përfaqësisë diplomatike, Prof. Giuseppe Antonio Chiaramonte si dhe Drejtoreshës së Drejtorisë së Studimeve dhe Publikimeve në QSPA Znj. Vilma Proko. Ishin të pranishëm dhe kryetarë të disa komunave të tjera Arbëreshe si Palazzo Adriano.

Gjatë konferencës u vunë në dukje vlerat atdhedashëse të këtij komuniteti i cili ruan kulturën, traditat, gjuhën doket dhe zakonet e atdheut mëmë dhe i trasmenton ato brez pas brezi nga nëna te fëmija.

Pjesë e këtij aktiviteti ishte dhe zhvillimi i një takimi me Vescovo të Piana degli Albanesi Z. Giorgio Demetrio Gallaro.



AGJENCIA KOMBËTARE E DIASPORËS

Në vijimësi u zhvillua një takim i përbashkët me Kryetarin e Bashkisë së Palermos, Prof. Leoluca Orlando dhe Kryetarin e Bashkisë së Horës së Arbëreshëve, Z.Rosario Petta. Gjatë takimit u vu theksi mbi identitetin dhe integrimin e Diasporës Shqiptare Arbëreshe në Itali “Identiteti është zgjedhje” dhe rëndësinë e politikave të shtetit pritës në integrimin e komunitetit shqiptar si dhe projektet në vijim të Agjencisë Kombëtare të Diasporës.

U kryen vizita zyrtare në Portale della Ginestra, Kisha S.Giorgio Megalomartire, Muzeu Civico Nicola Barbato ku gjenden të dokumentuara kultura dhe veshje të Komunitetit Arbëresh në Itali ndër shekuj.

Në përfundim të takimeve u vu theksi dhe ne zhvillimin e projekteve të posaçme për këtë komunitet si çelja e një shkolle për mësimin e gjuhës shqipe si dhe projekte të posaçme dedikuar të rinjve për të njohur Shqipërinë duke e vizituar atë, apo nëpërmjet ofrimit të bursave të studimit specifike për këtë komunitet bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr .447, Datë 22.7.2021 “Për kriteret e dhënies së bursave për shtetasit e huaj me origjinë shqiptare, për të studiuar në Republikën e Shqipërisë, nga Agjencia Kombëtare e Diasporës për vitin akademik 2021-2022”.

Pjesë e këtij aktiviteti ishte zhvillimi i një koncerti klasik me performancë të artistit të mirënjohur Aulon Naçi dhe përfaqësues nga TKOB, një formacion orkestral i nivelit të lartë të muzikës instrumentale shqiptare duke gërshetuar të folurën e sotme, gjuhën shqipe letrare të ditëve të sotme dhe gjuhën shqiptare arbëreshe nëpërmjet artit të bukur të fjalës dhe muzikës, prezantimin e kulturës shqiptare në rajonin ku u zhvillua: Piana degli Albanesi në Siçili, duke shërbyer në konsolidimin e marrëdhënieve shqiptare me ato arbëreshe të vendit fqinj.

✓ **Cerzeto, Kalabri:**

Agjencia Kombëtare e Diasporës zhvilloi takime në Komunën e Cerzeto, me Kryetarin e Bashkisë së Cerzeto.

Gjatë takimit me Kryetarin e Bashkisë së Cerzeto u diskutua mbi rëndësinë dhe vlerat që mbart komuniteti Arbëresh në Itali, në drejtim të ruajtjes së gjuhës, traditave, kulturës, dokeve e zakoneve si dhe zhvillimin dhe realizimin e projekteve të përbashkëta.

U zhvillua vizitë zyrtare në ambientet e Kishës Fan Andon Santori dhe në Muzeun Etnografik Arbëresh.

Takimet vijuan me Prof.Carmine Stamille dhe Prof.Italo Sarro të cilët kanë dhënë një kontribut të veçantë nëpërmjet botimeve të tyre shkencore në dokumentimin e kulturës Arbëreshe.





Gjatë sesionit të mbrëmjes, u zhvillua konferencë me prezantime të Kryetarit të Bashkisë së Cerzeto Z.Giuseppe Rizzo, Ambasadores së Kombit Prof.Cettina Mazzei, Drejtoreshës Ekzekutive të Agjencisë Kombëtare të Diasporës Znj.Sonila Hysi, përfaqësues nga Ambasada Shqiptare në Romë dhe Konsullata në Bari Znj.Genta Mburimi, Prof. Carmine Stamille, Prof. Italo Sarro, përfaqësues nga QSPA, znj.Vilma Proko si dhe personazhe të tjerë nga komuniteti Arbëresh, në Piazza Santi Pietro e Paolo.

Në përfundim u zhvillua dhe një koncert klasik i ndërthurur me poezi Arbëreshe.

- ✓ Po kështu është realizuar një dokumentar televiziv me titull “Ne jemi Arbëresh” dedikuar Komunitetit Arbëresh në Piana Degli Albanesi (Hora e Arbëreshëve), Siçili duke përfshirë dhe katër komunat në Santa Cristina Gela; Mezzojuso; Contessa Entellina, Palazzo Adriano.

Dokumentimi i vlerave të këtij komuniteti është dëshmi i ndërthurjes së të djeshmes me të tashmen, njohja e tyre i shërben jo vetëm brezit të ri por, gjithësecilit kudo në botë për vlerat e çmuara që mbart ky komunitet shqiptar atë të bujarisë, mikpritjes dhe mbi të gjitha të bashkjetesës midis popujve.

Dokumentimi televiziv i shërben diasporës shqiptare por dhe publikut të gjerë shqiptar e të huaj për njohjen e vlerave të jashtëzakonshme të këtij komuniteti shqiptar.

Dokumentari paraqet një rrëfim, në qendër të të cilit, është vendosja e shqiptarëve të parë në një zonë kodrinore, në gjysmën e dytë të shekullit XV, konkretisht në vitin 1488, kur dhe daton krijimi i kësaj qyteze në Siçili. Qyteti dhe banorët e tij, në çdo qelizë të jetës, zbulojnë edhe një pasuri tjetër, ndoshta atë më të madhen: identitetin etniko-gjuhësor, që ruhet nga shekulli XV e që përbën vlerën më të rëndësishme të shqiptarëve të Hora e Arbëresheve në Siçili.

Dokumentari është realizuar duke paraqitur mjedise si shtëpitë karakteristike, që ruajnë relike të kohëve të shkuara, objekte të trashëguara e deri në ditët e sotme. Një vend të veçantë zë episodi mbi historikun e Kishës së Pianës, trashëgimi kulturore duke filluar nga kishat e stilit barok, të cilat ruhen si dëshmi kulturore-artistike.

Të tilla janë afresket e Kishës së S. Demetrios, ikonat e Kishës së S.Nicoles, disa prej të cilave të shekullit XVII. Trashëgimia ikonografike e Eparkisë së Piana degli Albanesi është një prej thesareve të artit dhe të shpirtit arbëresh, e cila ka pasuruar edhe vetë artin siçilian deri në fund të shekullit XVII. Dokumentari i kushtoi një episod të veçantë edhe kostumeve të çmuara tradicionale femërore, të qendisura me ar dhe të zbukuruar nga argjendaritë siçiliane të shekullit XVII-XVIII.

Duke u ndalur edhe në qytetin e Palermos, u vu në pah se nga ky qytet i vogël, dolën edhe themeluesit e katedrave të gjuhës dhe letrarisë shqipe. Hora e Arbëreshëve: ruan edhe një pasuri tjetër, prodhimet tipike të gastronomisë planeze, si buka e famshme, embëlsira tipike cannolo etj të cilat janë ekspozuar dhe bërë pjesë e dokumentarit.



Dokumentari vijon me xhirime të realizuara në katër komunat në Santa Cristina Gela; Mezzojuso; Contessa Entellina, Palazzo Adriano.

Dokumentari televiziv, është bërë pjesë e pasurisë digjitale të Agjencisë.

5.2.AKTIVITETE PËR KOMUNITETIN SHQIPTAR NË GREQI

Në datat 5, 6 dhe 7 tetor 2021 në kuadër të programit “Ditëve të Shqipërisë”, Agjencia Kombëtare e Diasporës zhvilloi aktivitet me Komunitetin Shqiptar në Greqi.

Në këtë kuadër u zhvilluan takime me Ambasadoren e Republikës së Shqipërisë në Greqi, Oficeren Koordinuese për Diasporën dhe Këshilltar Ministri ku diskutua mbi nisma dhe projekte të përbashkëta për tu zhvilluar në të ardhmen.

Takimet vijuan me përfaqësues nga Shoqatat e komunitetit shqiptar në Greqi, kryesisht nga Athina dhe Greqia e Jugut. Gjatë takimeve u diskutua mbi programe dhe projekte të përbashkëta që fuqizojnë rolin e diasporës shqiptare në jetën ekonomike, politike dhe kulturore të vendit, si dhe duke dëgjuar nga afër problematikat dhe kërkesat e të gjitha shoqatave të pranishme.

✓ Takimi Gratë në Biznes

Organizimi i këtij takimi kishte si objekt vlerësimin nga Qeveria shqiptare të faktit se gratë janë motori kryesor i ekonomisë shqiptare, si konsumatore, menaxhere dhe drejtuese.

Kjo tregon frymën që Qeveria Shqiptare ka ndaj grave, vlerësimin për to i cili nuk tregohet veç me fjalë por me vepra, duke i vendosur gratë në pozicione kyçe të vendimmarrjes, drejtimit dhe përfaqësimit të vendit. Takimi i realizuar është një pohim jo vetëm ekonomik por edhe për jetën sociale të shoqërisë shqiptare.

Gjatë takimi u realizua një bashkëbisedim produktiv me gratë pjesmarrëse ku u theksua rritja e rolit të grave në diasporë jo vetëm në fushën ekonomike por edhe për jetën sociale e në veçanti në ruajtjen e gjuhës, kulturës e traditave shqiptare nëpërmjet edukimit patriotik të fëmijëve, ku ato luajnë rolin primar në familje.





Agjencia Kombetare e Diasporës, nëpërmjet projekteve të posaçme, do të ketë prioritet fuqizimin e rolit të gruas në diasporë, rritjen e rolit të saj në biznes, në kulturë e në cdo fushë të jetës pasi konsideron barazinë gjinore një element kyç të zhvillimit të shoqërisë shqiptare.

✓ **Takim me artistët:**

Në këtë takim u theksua se për Agjencinë Kombëtare të Diasporës është shumë e rëndësishme të ishte pranë artistëve shqipëtarë në Greqi, duke qenë se ata janë një element jashtëzakonisht i rëndësishëm për ruajtjen e kulturës shqiptare duke krijuar ura lidhëse mes kulturës së vendit të origjinës dhe shtetit pritës.

Arti dhe kultura kanë shërbyer shpesh si ambasadorët më të mirë të paqes dhe prosperitetit në botë, por jo vetëm kaq. Artistët shqiptarë në diasporë, veçse na bëjnë krenarë, krijojnë ura lidhëse mes kulturës së vendit të origjinës dhe shtetit pritës, duke forcuar jo vetëm marrëdhënien e artistëve me shtetin mëmë, por edhe duke lehtësuar procesin i integritimit të tyre në shtetin pritës.

Arti kapërcen çdo barrierë, distancë, kufi territorialë, duke shërbyer si urë lidhëse ndërmjet artistëve por dhe publikut të gjerë, e madje dhe vetë shteteve. Gjatë këtij takimi u diskutua mbi hartimin e nismave të përbashkëta të projekteve artistike dhe bashkëpunimi në evidentimin artistëve shqiptarë të diasporës për të siguruar pjesëmarrjen e tyre në aktivitete të përbashkëta promovuese.

✓ **Takim me studentët**

Në fokus ishte promovimi i të drejtave të shqiptarëve në diasporë dhe angazhimi i diasporës në jetën e vendit dhe roli i veçantë që studentët mbartin në këtë qasje.

Sfidat me të cilat përballen studentët në diasporë janë nga më të ndryshmet dhe jo vetëm ligjore apo institucionale por edhe sociale, duke qenë se shkëputen nga familja në një moshë të re për një mision të rëndësishëm sikurse është arsimi dhe dija. Por, është pikërisht ky mision që i bën studentët në diasporë ambasadorët më të mirë të Shqipërisë në botë.

Në takim u theksua krijimi i data bazës së studentëve në diasporë por dhe Platforma Rrjeti i Profesionistëve, me qëllim ndërveprimin midis tyre.



- ✓ Në përfundim të aktivitetit u zhvillua Wokshop për mësimin e këngëve dhe valleve, leximin e librave shqip për fëmijët shqiptarë në diasporë si dhe ekspozitë e veshjeve tradicionale të të gjithë krahinave të Shqipërisë.
- ✓ Pjesë e këtij eventi ishte dhe zhvillimi i një aktiviteti artistik nga Ansambli Kombëtar e Këngëve dhe Valleve Popullore.

Me datë 29.11.2021 u zhvillua në Teatrin Kombëtar në Athinë Greqi, aktiviteti artistik “Tingujt e vendit tim”, në kuadër të aktiviteteve “Nëntori Shqiptar” të Ambasadës së Republikës së Shqipërisë në Greqi.

Mbështetja e Agjencisë Kombëtare të Diasporës në realizimin e këtij aktiviteti, në kuadër të festave kombëtare të 28 – 29 Nëntorit, vjen në vazhden e aktivitetve të dedikuara Komunitetit Shqiptar në Greqi, në kuadër të programit vjetor të aktiviteteve “Ditet e Shqipërisë”.

Aktiviteti artistik u zhvillua me performancën e 7 artistëve (instrumentistë), me drejtues artistik, kompozitorin Z.Aulon Naçi, në cilësinë e bashkëpunorit të jashtëm të Agjencisë Kombëtare të Diasporës. Aktiviteti u realizua duke ndërthurur me pjesëmarrjen e tre balerinëve me origjinë shqiptare, si dhe performancën e këngëtarës së mirënjohur greke znj. Glykeria Kotsoula, e cila performoi së bashku me grupin e saj muzikor dy këngë shqiptare. Në këtë aktivitet morën pjesë Ministri i Jashtëm i Greqisë, Ambasadorja e Republikës së Shqipërisë në Greqi, si dhe personalitete të fushave të ndryshme.

5.3.AKTIVITETE PËR KOMUNITETIN SHQIPTAR NË KROACI

Me qëllim ruajtjen e gjuhës dhe vlerave kulturore kombëtare të komunitetit shqiptar në Kroaci, Agjencia Kombëtare e Diasporës, në bashkëpunim me Shoqatën Teatrore Shqiptare në Kroaci “Mërgimtari”, mundësuan shfaqjen e premierë - komedisë “Pacienti i Doktor Frojdit” të dramaturgut kroat Miro Gavran në gjuhën shqipe në datë 14 Nëntor 2021 në Zagreb.





5.4. AKTIVITETE PËR KOMUNITETIN SHQIPTAR NË UKRAINË

Agjencia Kombëtare e Diasporës realizoi një program kushtuar shqiptarëve të Ukrainës me qëllim forcimin e mëtejshëm të urave të bashkëpunimit me diasporën.

Agjencia Kombëtare e Diasporës në bashkëpunim me Ansamblin Kombëtar të Këngëve dhe Valleve Popullore organizoi një koncert me muzikë dhe valle tradicionale shqiptare për nxënësit nga Ukraina, të cilët vizituan Shqipërinë në muajin maj 2021.

Aktiviteti kishte në fokus promovimin e identitetit kombëtar, kulturës dhe gjuhës shqipe.

Gjatë koncertit u interpretuan edhe valle tradicionale të përbashkëta midis trupës profesionale të Ansamblit dhe nxënësve të ardhur nga Ukraina.

Organizimi i këtij aktiviteti artistik erdhi në vazhdim të aktiviteteve në kuadër të marrëveshjes me Teatrin Kombëtar të Operas dhe Baletit, ku me herët janë organizuar klase të mësimi të valleve dhe kulturës shqiptare për komunitetin shqiptar në Karakurt, Tyushki, Divnyns`ke dhe Gamovka.

Në datë 25 Tetor 2021, Drejtoresha Ekzekutive e Agjencisë Kombëtare të Diasporës znj. Sonila Hysi zhvilloi takim me Konsullin e Nderit të Republikës së Shqipërisë në Ukrainë, Z. Shahin Omarov me fokus një sërë nismash të përbashkëta në mbështetje të komunitetit shqiptar në Ukrainë. Objekt i takimit ishte vijimi i bashkëpunimit institucional dypalësh për realizimin e projekteve të përbashkëta në të ardhmen si vendosjes së bustit të Nënë Terezës në Ukrainë, një nismë e cila dëshmon vullnetin e Shqipërisë dhe shtetit pritës Ukrainës për forcimin e marrëdhënieve të komunitetit shqiptar me vendin e tyre të origjinës si dhe projekte të tjera.

5.4 AKTIVITET ME KOMUNITETIN SHQIPTAR NË MBRETËRINË E BASHKUAR

Më datë 12 nëntor 2021, Drejtoresha Ekzekutive e Agjencisë Kombëtare të Diasporës, znj. Sonila Hysi mori pjesë në Konferencën mbi 100-vjetorin e marrëdhënieve diplomatike mes Shqipërisë dhe Mbretërisë së Bashkuar. Pjesë e këtij aktiviteti ishin pjesëtarë të diasporës shqiptare në Londër si dhe personalitete nga Shqipëria dhe Mbretëria e Bashkuar, ndër të cilët Kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste,



Z. Taulant Balla, Kryetari i NënKomisionit për Diasporën dhe Migracionin, Z. Lavdrim Krashi dhe përfaqësues të shoqatave shqiptare në Londër në bashkëpunim me institucionet e Mbretërisë së Bashkuar.

Në datë 13 Nëntor 2021 Drejtoresha Ekzekutive e Agjencisë Kombëtare të Diasporës, Znj. Sonila Hysi vizitoi shkollën e mësimit plotësues të krijuar nga shoqata shqiptare “Ardhmëria” në Londër, kryesuar nga Z. Lutfi Vata, njëkohësisht “Ambasador Kombi” i Shqipërisë në Mbretërinë e Bashkuar. Të pranishëm në këtë vizitë ishin edhe Z. Taulant Balla, Kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste dhe Z. Erion Veliaj, Kryetar i Bashkisë Tiranë.

Nxënësit shqiptarë në Londër ia dedikojnë çdo të shtunë mësimit të gjuhës dhe kulturës shqiptare ku mësojnë dhe kultivojnë gjuhën dhe kulturën shqipe.

Në vazhden e aktiviteteve me komunitetin shqiptar në Mbretërinë e Bashkuar në përputhje me programin vjetor të aktiviteteve, janë realizuar takime me përfaqësues të shoqatave shqiptare dhe vizita institucionale në shkolla të mësimit të gjuhës shqipe në Londër, në datat 18 dhe 19 nëntor 2021.

5.5 AKTIVITET ME KOMUNITETIN SHQIPTAR NË TURQI.

Në datë 29 dhe 30 Nëntor 2021, në kuadër të konsolidimit të marrëdhënieve institucionale me komunitetin shqiptar në Turqi, u zhvillua në Stamboll event institucional me Z. Bora Zukali, “Ambasador i Kombit” dhe kryetar i shoqatës “Vatra” në Stamboll si dhe me përfaqësues të shoqatave të tjera aktive në këtë komunitet si dhe me personalitete të spikatura nga fusha të ndryshme, për realizimin e projektit kushtuar diasporës shqiptare në Turqi, ngritja e Qendres Kulturore në Stamboll, mësimi i gjuhës shqipe, krijimi i një fjalori dy gjuhësh, i cili ka si qëllim ruajtjen e gjuhës shqipe, vlerave kombëtare dhe kulturore në diasporën shqiptare në Turqi.

5.6 AKTIVITET ME KOMUNITETIN SHQIPTAR NË SHBA

Në kuadër të realizimit të misionit të Agjencisë Kombëtare të Diasporës, bazuar në Ligjin nr.115 datë 18.12.2017 “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës” i





ndryshuar, me qëllim forcimin dhe konsolidimin e bashkëpunimit institucional me diasporën dhe ruajtjen e kulturës shqiptare, për celebrimin e jetës, kulturës, traditës shqiptare në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në vijimësi të programit vjetor të aktiviteteve me komunitet shqiptare në diasporë, miratuar me vendim të Këshillit Drejtues, Agjencia Kombëtare e Diasporës në bashkëpunim me Fondacionin “Tradita Popullore” realizoi një ekspozitë me veshje dhe suvenirë me motive tradicionale shqiptare.

5.7 AKTIVITETI “DITA E DIASPORËS”

Agjencia Kombëtare e Diasporës, në datë 18 dhjetor 2021, me rastin e Ditës Kombëtare të Diasporës, realizoi projektin “Ne flasim shqip”. Video promovionale ka si qëllim ruajtjen e gjuhës shqipe dhe trashëgimisë kulturore.

5.8 AKTIVITETE TË TJERA

Gjatë vitit 2021, Agjencia Kombëtare e Diasporës ka mbështetur dhe aktivitete të tjera kulturore- artistike si:

✓ Festivali “Za Fest”

Agjencia Kombëtare e Diasporës, në përmbushje të misionit të saj për zhvillimin dhe konsolidimin e bashkëpunimit institucional me diasporën, për ofrimin e ndihmes për ruajtjen e gjuhës dhe trashëgimisë kulturore kombëtare dhe në vijim të Programit vjetor të aktiviteteve, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKD, nr.3 datë 28.06.2021, ka mbështetur realizimin e Festivalit “Za Fest”, në muajin Korrik-Gusht 2021, në edicionin e 5-të, krijuar nga kantautori Vlashent Sata, me qëllim krijimin e një strukture që promovon vlerat dhe kulturën shqiptare. Aktiviteti është zhvilluar në disa skena në qytetin e Shkodrës, si Shirokë, Kalaja e Rozafës dhe Pedonale i ndërthurur me muzikë, teatër, balet, kinema dhe sporte. Aktiviteti përmbushi pritshmëritë në promovimin e natyrës, traditave dhe kulturës shqiptare, si dhe duke mbështetur zhvillimin e turizmit. Në festival morën pjesë shqiptarë nga të gjitha trevat brenda dhe jashtë vendit, si dhe vizitorë të huaj. Gjatë Festivalit ZA FEST performuan artistët nga Diaspora si: Gjon Tears, Vlashent Sata, Gentjan Doda, Eklant Hasa, Josif Gjipali.

✓ Dokumentari dedikuar ‘Nënë Terezës’

Agjencia Kombëtare e Diasporës, në nderim të ditës së 5 Shtatorit “Dita e Shenjtërimit të Nënë Terezës”, ka bërë të mundur realizimin e një dokumentari me metrazh të





shkurtër, dedikuar Nënë Terezës, simbol i paqes, bamirësisë dhe i virtyteve më të larta njerëzore, për të cilën krenohet e gjithë Shqipëria.

✓ **Aktivitet për promovimin e albumit të parë muzikor të Grupit Arbëresh “SHEGA”**

Agjencia Kombëtare e me qëllim ruajtjen dhe promovimin e vlerave të identitetit kombëtar dhe trashëgimisë kulturore, si dhe forcimin dhe konsolidimin e bashkëpunimit institucional me diasporën, në kuadër të promovimit të artistëve shqiptarë në diasporë, ka mundësuar realizimin e aktivitetit artistik, për promovimin e albumit të parë muzikor të Grupit Arbëresh “SHEGA”. Grupi Arbëresh “SHEGA”, është një grup muzikor i njohur, i përbërë nga pesë artistë të rinj Arbëreshë nga “Hora e Arbëreshëve” Itali, të cilët kanë dhënë një kontribut të rëndësishëm për promovimin dhe ruajtjen e vlerave kulturore dhe artistike të shtetit shqiptar.

✓ **Festivali kulturor Shqipëri-Izrael,**

Agjencia Kombëtare për Diasporën, ka mbështetur Festivalin Kulturor Israel-Shqipëri, me datë 22 Shator 2021. Festivali është një aktivitet që promovon vlerat më të rëndësishme të miqësisë mes shteteve dhe kombeve. Arti dhe kultura kanë treguar se shërbejnë si ura komunikimi mes popujve dhe njerëzve dhe si instrumentet më të mirë për t’i bërë bashkë ata, ndaj përpiqemi që këto ura të vazhdojnë të forcohen për dekadat e ardhshme, duke promovuar sa më shumë aktivitete të tilla të përbashkëta.

✓ **Realizimi i videos promovuese “Eja në Shtëpi”.**

Agjencia Kombëtare e Diasporës, ka mundësuar realizimin e një videoje promovuese me titull “Eja në Shtëpi”. Video promocionale synon pasqyrimin e vlerave të turizmit shqiptar dhe shërben si një thirrje drejtuar diasporës shqiptare me qëllim forcimin e lidhjeve me vendin e origjinës.

✓ **Mbështetja e artistit Andrea Rama në realizimin e Festivalit “Tirana International Music Dance Theater Festival - 2”.**

Agjencia Kombëtare e Diasporës, me qëllim forcimin dhe konsolidimin e bashkëpunimit institucional me diasporën, në kuadër të promovimit të artistëve shqiptarë, ka siguruar mbështetjen e artistit nga diaspora shqiptare në Greqi Z.Andrea Rama, drejtues artistik dhe koreograf i koncertit të zhvilluar me datë 18 Tetor 2021, në Tiranë. Z.Andrea Rama, është artist i mirënjohur nga diaspora shqiptare në Greqi, që ka dhënë një kontribut të rëndësishëm për promovimin dhe ruajtjen e vlerave kulturore dhe artistike të shtetit shqiptar.





- ✓ Është vijuar me prezantimin dhe dhurimin një sërë institucioneve shqiptare dhe personaliteteve të diasporës të Albumit “Kadare dhe Gjirokastra” realizuar nga Agjencia Kombëtare e Diasporës, me fotografinë e artistit Roland Tasho në përvjetorin e tetëdhjetë e pestë të lindjes së gjeniut të letërsisë shqipe Ismail Kadare.

6. OFRIMI I BURSIVE PËR STUDENTËT E HUAJ ME ORIGJINË SHQIPTARE

Në vitin 2021 në kuadër të ofrimit të ndihmës për ruajtjen e gjuhës dhe trashëgimisë kombëtare, si dhe forcimit të lidhjeve me vendin e origjinës, Agjencia Kombëtare e Diasporës, në përputhje me Vendimin Nr. 447, datë 22.07.2021 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret e dhënies së bursave për shtetasit e huaj me origjinë shqiptare, për të studiuar në republikën e shqipërisë, nga Agjencia Kombëtare e Diasporës për vitin akademik 2021-2022”, do të financojë 9 bursa për studentët e huaj me origjinë shqiptare.

Bursat do të ofrohen për shtetasit e huaj me origjinë shqiptare, për të studiuar në Republikën e Shqipërisë për vendet si më poshtë vijon:

- a. 2 (dy) bursa studimi për shtetasit e huaj me origjinë shqiptare nga Ukraina;
- b. 2 (dy) bursa studimi për shtetasit e huaj me origjinë shqiptare të komunitetit Arbëresh në Itali;
- c. 2 (dy) bursa studimi për shtetasit e huaj me origjinë shqiptare në Kroaci;
- ç. 2 (dy) bursa studimi për shtetasit e huaj me origjinë shqiptare nga Bullgari;
- d. 1 (një) bursë studimi për shtetasit e huaj me origjinë shqiptare nga Turqia.

Agjencia Kombëtare e Diasporës do të kryejë pagesat e mësuesve të nevojshëm për mësimin e gjuhës shqipe në vitin e parë të studimeve për shtetasit e huaj me origjinë shqiptare të cilët përfitojnë bursa studimi nga Republika e Shqipërisë për vitin akademik 2021-2022.

7. DATABAZA E STUDENTËVE

“Krijimi i Bazës së të Dhënave Shtetërore të Studentëve të cilët studiojnë jashtë vendit, dhe shtetasve të huaj me origjinë shqiptare, të cilët përfitojnë bursa nga Republika e Shqipërisë” vjen si produkt “All In One” i Agjencisë Kombëtare të Diasporës.





Portali përbën zhvillimin e një sistemi informatik për automatizimin e procedurës së përfitimit të bursave të studimit nga Republika e Shqipërisë, i cili është në zbatim të politikave të institucionit dhe konsiston në përmirësimin e procesin e regjistrimit, verifikimit dhe menaxhimit të të gjithë të dhënave të nevojshme të studentëve, të cilët studiojnë jashtë vendit dhe shtetasve të huaj me origjinë shqiptare, të cilët përfitojnë bursa studimi nga Republika e Shqipërisë”.

Kjo është një nismë e cila ka në fokus rritjen e ndërveprimit me studentët duke lehtësuar komunikimin dhe ndërveprimin ndërmjet tyre. Ajo u vjen në ndihmë studentëve shqiptarë në diasporë duke iu ofruar mundësinë për të kapërcyer barrierat gjeografike. Data baza e studentëve shqiptarë në diasporë është një portal që synon të mbështesë e të nxisë zhvillimin e Shqipërisë duke ofruar një "Urë Komunikimi për Diasporën" duke ofruar të dhëna mbi studentët, degët dhe vendin ku studiojnë, analiza statistikore, forumin i cili përfshin interaktivitetin me qëllim që studentët të komunikojnë me njëri-tjetrin.

8. SEKTORI I PROJEKTEVE

8.1.Njësia e Menaxhimit të Projekteve është përgjegjëse:

- Për planifikimin, drejtimin dhe zbatimin e projekteve në përputhje me misionin e institucionit dhe në nxitje të sipërmarrjes së Diasporës për zhvillimin social-ekonomik dhe kulturor.
- Koordinon me donatorët e projekteve në realizimin e objektivave dhe veprimtarisë të Agjencisë Kombëtare të Diasporës për Zhvillimin e Diasporës.

8.2.PROJEKTET E PLANIFIKUARA PËR ZBATIM

8.2.1. Rrjetëzimi i studentëve të diasporës

Qëllimi dhe objektivat e këtij projekti janë: Inicimi i ngritjes së mekanizmave për të përthithur angazhimin e studentëve të diasporës së komunitetit të shqiptarëve në Greqi si projekt pilot. Studimi i situatës së migrimit të studentëve shqiptarë dhe identifikimi i hapësirave për angazhimin e diasporës. Organizimi i rrjetit të studentëve të diasporës dhe ndërtimi të databazës së studenteve në diasporë. Pilotim i modelit të *brain gain* të





studentëve shqiptarë në komunitetin e shqiptarëve në Greqi dhe shpërndarja e modelit në nivel rajonal.

8.2.2. Fuqizimi i Grave në Diasporë

Ky projekt synon fuqizimin e grave në diasporën, të cilat kanë nevojë për mbështetje nga qeveria shqiptare për kapërcimin e sfidave të ndryshme me të cilat përballen. Synimi është që ky projekt të bëhet i zbatueshëm dhe për komunitetet e tjera të diasporës, ku preken këto problematika. Si: Shërbime bazë; Përkujdesje sociale; Përkujdesje shëndetësore; Formim profesional; Dokumentacion provizor për të lehtësuar lëvizjen dhe respektimin e të drejtave themelore të njeriut; Ndihmë psikologjike; Krijimi i rrjetit të grave në diasporë që të motivojnë dhe mbështesin njëra-tjetrën.

8.2.3. Shërbimet për diasporën pranë Njërive të Vetëqeverisjes Vendore (NJVV)

Bashkëpunimi me Prefekturat përkatëse për të fuqizuar komunikimin mes Sektorit të Projekteve dhe NJVV-ve. Informimi i diasporës shqiptare mbi NJVV-të dhe funksionalitetin e tyre. Ndërmjetësimi mes NJVV-ve dhe investitorëve potencialë të diasporës duke përdorur si urë komunikimi Sektorin e Projekteve të AKD-së. Promovimi i hapësirave për punësim për të rinjtë nga diaspora që duan të angazhohen pranë sektoreve të ndryshme të NJVV-ve.

8.2.4. Diaspora Shqiptare në Turqi

Projekti kushtuar shqiptarëve të Diasporës në Turqi ka për qëllim forcimin e urave të bashkëpunimit me diasporën dhe ruajtjen e gjuhës dhe vlerave kulturore kombëtare të shqiptarëve në Turqi. Objektivat e projektit janë forcimi i gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në komunitetin shqiptarë në Turqi. Krijimi lidhjeve të bashkëpunimit me institucioneve shqiptare dhe shoqatave në diasporë.

8.3.KOORDINIM ME DONATORËT E PROJEKTEVE NË REALIZIMIN E OBJEKTIVAVE DHE VEPRIMTARISË SË AKD-SË

8.3.1. “Follow up - Workshop” me Agjencia Gjermane për Bashkëpunim dhe Zhvillim (GIZ) në kuadër të projektit PMD dhe nga partnerët lokalë.

Në vazhdim të projektit PMD, drejtuesja e këtij projekti zhvilloi në Shqipëri një “Follow up - Workshop”. Objektivi i këtij seminari ishte një diskutim interaktiv me



Institucionet Partnere duke u fokusuar në rezultatet e arritura deri më tani dhe në nevojën për zgjerimin e aktiviteteve për forcimin e kapaciteteve, në identifikimin e nevojave të tyre për trajnime të ardhshme mbi migrimin e orientuar drejt zhvillimit, si dhe vlerësimin e qasjeve më të mira për shpërndarjen e mëtejshme të masave për ngritje së kapaciteteve të reja. Gjatë seminarit, Sektori i Projekteve të AKD-së prezantoi projektin “Shërbimet për diasporën pranë Njësive të Vetëqeverisjes Vendore (NJVV)”. Ky projekt u prit shumë mirë nga drejtuesit e projektit PMD dhe nga partnerët lokalë, duke parashikuar një vijimësi për hapa konkrete drejt zbatimit të projektit në sesionin e radhës së seminarit në Nëntor, ku pritet të finalizohet projekti PMD si dhe ku do të përcaktohen objektivat për vitin e ardhshëm.

8.3.2. Mundësi angazhimi dhe financimi për studentët shqiptar në Gjermani

Gjatë vitit 2021, Qendra për Migracionin dhe Zhvillimin Ndërkombëtar (CIM) dhe Agjencia Gjermane për Bashkëpunim dhe Zhvillim (GIZ), nën organizimin e GERMIN, zhvilloi një takim me studentet në Gjermani mbi mundësitë e angazhimit në Shqipëri dhe Kosovë përmes programit të GIZ “Migracioni dhe Diaspora” me përfaqësim të CIM/GIZ në Shqipëri, CIM/GIZ në Kosovë si dhe përfaqësues të sektorit të projekteve të Agjencisë Kombëtare të Diasporës. Në këtë takim, AKD-ja u prezantua platforma e Databazës së Studentëve, ku u theksua fakti se kjo databazë ka si qëllim zhvillimin një sistemi informatik dhe menaxhimi i të dhënave të nevojshme të studentëve Shqiptarë. Institucion administrues e bazës së të dhënave shtetërore e studentëve shqiptarë është Agjencinë Kombëtare të Diasporës. Kjo platformë u prit me shumë interes nga të gjithë studentët e pranishëm në këtë takim.

8.3.3. Agjencia Kombëtare e Diasporës bëhet pjesë e projektit rajonal “Marginal resilience: The circular economy model for the enhancement of territorial vocations”.

Në kuadër të projektit Rajonit Puglia në Itali “Marginal resilience: the circular economy model for the enhancement of territorial vocations” janë zhvilluar takime virtuale dhe fizikisht ndërmjet palëve pjesëmarrëse në projekt: Noè Andreano, Kryetar i Komunës Casavecchio në Puglia, përfaqësuese e Konsullatës së Përgjithshme të Italisë në Vlorë, Drejtues i Zyrës së Koordinimit në Tiranë, Agjencia Kombëtare e Diasporës,





përfaqësues nga Bashkia Vlorë dhe të entit propozues të Projektit, si dhe përfaqësues të kulturës nga Rajoni Puglia. Gjatë takimeve është prezantuar projekti në tërësi si dhe është diskutuar mbi fazat e zbatimit konkret dhe shkallën e përfshirjes/angazhimit të palëve në projekt.

8.3.4. Takim pune në Ministrinë e Brendshme të Kosovës për shkëmbimin e praktikave për Ri-integrimin e Personave të Riatdhesuar

Përfaqësuesit e Agjencisë Kombëtare të Diasporës zhvilluan takim me Sekretaren e Përgjithshme të Ministrisë për Punët e Brendshme në Kosovë dhe përfaqësues të Departamentit për Ri-integrimin e Personave të Riatdhesuar në Kosovë. Gjatë këtij takimi u theksua, vijimi i bashkëpunimit institucional si dhe u diskutuan çështje apo projekte konkrete të këtij bashkëpunimi dypalësh, si më poshtë:

- Elementët e përbashkët dhe veçoritë ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës për çështjet e migracionit dhe diasporës;
- Legjislacioni në fuqi në Kosovë dhe Shqipëri për migracionin dhe diasporën (Analizë krahasuese);
- Portali on-line dhe funksionimi i tij, gama e shërbimeve të ofruara në nivel kombëtar në Kosovë dhe Shqipëri;
- Votimi i emigrantëve;
- Aspekte të veçanta të riintegrit të personave të riatdhesuar, koordinimi i Departamentit të për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar, dhe Departamentit për Shtetësi, Azil dhe Migracion pranë Ministrisë së Brendshme në Prishtinë dhe Njësive Vendore, skemat emergjente dhe të qëndrueshme të ofruara në mbështetje të personave të kthyer nga migracioni/diaspora, bashkëpunimi me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale si dhe Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive në Kosovë për riintegrimin e të riatdhesuarve.

8.3.5. Roli i Diasporës në integrimin e vendit në bazë të programit “Angazhimi i Diasporës Shqiptare në Zhvillimin Social dhe Ekonomik të Shqipërisë”



Në kuadër të programit “Angazhimi i Diasporës Shqiptare në Zhvillimin Social dhe Ekonomik të Shqipërisë” në takimin “Roli i Diasporës në Integrimin Evropian të Vendit”, janë prezantuar nëpërmjet një ceremonie online ekspertët e përzgjedhur që jetojnë në vende të ndryshme jashtë Shqipërisë që do të kenë rol në integrimin e vendit në BE. Në takim është theksuar fakti se, ekspertët e përzgjedhur përbëjnë një vlerë të shtuar për administratën shqiptare në një proces që nga pikëpamja profesionale nuk do të jetë i lehtë. Në mënyrë zyrtare procesi i integrimit të Shqipërisë në BE do të ketë ndihmën, asistencën dhe pjesëmarrjen zyrtare dhe ndihmën e zyrës së IOM në Tiranë për procesin e integrimit. Të gjithë pjesëmarrësit në këtë program do të realizojnë në fokusi të punës prioritetet politike dhe statregjike të vendit tonë në fushën e integrimit evropian dhe përqasje sektoriale në tërësi.

8.3.6. Cikli i trajnimeve në kuadër të Programit “Migrim dhe Diasporë”

Programi “Migrim dhe Diasporë”, kishte synim fuqizimin e rolit të diasporës dhe migrantëve në zhvillimin ekonomik vendor në Shqipëri, ka vazhduar në disa faza trajnimesh me temë: “Migration Governance and Migration and Development with the focus on Engagement of Diaspora, and Migration Data”, “Project Cycle Management” dhe “Data Collection, Interpretation and Analysis” pjesë e projektit “Diaspora and Return Migrants engaged in Local Strategic Development Plans at the Municipal Level”. Trajnimet u zhvilluan nga Shoqëria Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ). Këto trajnime kishin në fokus rritjen e kapaciteteve të zyrtarëve të Agjencisë Kombëtare të Diasporës dhe të institucioneve të Qeverisjes Vendore: Bashkia Tiranë Durrës, Lezhë, Shkodër, Kukës, Elbasan, Korçë, Fier, Berat and Vlorë, mbi migracionin në përgjithësi, zhvillimin dhe implementimin e politikës së migracionit, angazhimin e Diasporës në zhvillimin socio-ekonomik vendor, rritjen e kapaciteteve të personelit të institucioneve të Diasporës në Republikën e Shqipërisë për të dizenuar dhe implementuar projekte zhvillimi dhe përvetësimin e koncepteve analitike dhe strategjike.



8.4. PRITSHMËRITË PËR TË ARDHMEN

- ✓ Një objektiv në të ardhmen do të jetë koordinimi me donatorët e projekteve në realizimin e objektivave dhe veprimtarisë të Agjencisë Kombëtare të Diasporës për Zhvillimin e Diasporës.
- ✓ Fokusi kryesor i punës do të jetë zbatimi dhe krijimi i programeve të zgjerimit nga viti i kaluar, për zhvillimin dhe zgjerimin e mëtejshëm të rrjeteve të profesionistëve. Rrjetëzimi i diasporës në të gjithë fushat ku ata punojnë dhe jetojnë. Rrjetëzimi i profesionistëve në diasporës në fushën e shkencës, kërkimit shkencor, zhvillimeve në teknologji dhe inovacion në nismën e quajtur “Kthimi i trurit”.
- ✓ Strategjia Kombëtare për Migracionin, e miratuar në vitin 2019 nga Qeveria Shqiptare, parashikon realizimin e një procesi rishikimi afatmesëm të Planit të Veprimit për Migracionin, me qëllim që të merren në konsideratë tendencat e reja të migracionit. Në këtë kuadër parashikojmë një projekt për “Përmirësimin e Koordinimit të Qeverisjes së Migracionit dhe Diasporës në Shqipëri”, zbatuar nga GIZ në Shqipëri dhe IOM Tirana, nëpërmjet mbështetjes financiare të Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, në emër të Ministrisë Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim.
- ✓ Ngritje kapacitetesh për trajnimin e mëtejshëm të stafit për njohuritë mbi tendencat e reja të migracionit dhe diasporës.

9. AKTE, MARRËVESHJE DHE MEMORANDUME

Eksperienca e fituar nga rritja e vëllimit të punës së Agjencisë sollën nevojën e ndryshimeve ligjore të diktuar kryesisht nga nevojat institucionale.

Gjatë vitit 2021 nga stafi i AKD u punuan për draftimin dhe realizimin e akteve ligjore dhe nënligjore:

9.1. Ligje

LIGJ 35/2021 datë 16.03.2021 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.115/2017 “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës”.





9.2.Vendime të Këshillit të Ministrave:

- ✓ VENDIM Nr.403, datë 30.06.2021 i Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave të përgjithshme, kriterëve dhe procedurave specifike për marrjen me qira të ambienteve dhe lidhjen e kontratave të veçanta me bashkëpunetorë të jashtëm ose figura të njohura shqiptare në diasporë, të cilat nevojiten të kryhen me qëllim zbatimin dhe realizimin e programit vjetor të Agjencisë Kombëtare të Diasporës dhe që nuk rregullohen nga legjislacioni në fuqi për prokurimin publik”.
- ✓ VENDIM Nr.447, datë 22.07.2021 i Këshillit të Ministrave “Për kriteret e dhënies së bursave për shtetasit e huaj me origjinë shqiptare, për të studiuar në republikën e shqipërisë, nga Agjencia Kombëtare e Diasporës për vitin akademik 2021-2022”.

9.3.Urdhëra institucionale:

- ✓ URDHËR Nr. 30, datë 17.2. 2021 i Kryeministrit “Për përcaktimin e grupit të koordinatorëve për zbatimin e planit të veprimit të strategjisë kombëtare për diasporën 2021-2025.
- ✓ URDHËR Nr.66, Datë 30.07.2021 Për Caktimin e Koordinatorit Shtetëror për Realizimin e Programit “Jam Shqiptar” të Gjuhës dhe Kulturës Shqipe.

9.4.Memorandume bashkëpunimi

Agjencia Kombëtare e Diasporës, gjatë vitit 2021 ka nënshkruar disa marrëveshje dhe memorandume bashkëpunimi:

- ✓ Memorandum bashkëpunimi ndërmjet Agjencisë Kombëtare të Diasporës dhe Urdhrit të Stomatologut të Shqipërisë, datë 05.03.2021.

Qëllimi i këtij Memorandumi është nxitja e bashkëpunimit midis Palëve për promovimin dhe koordinimin e lidhjeve me profesionistët shqiptarë në fushën e stomatologjisë në Shqipëri dhe shtetet pritëse në diasporën shqiptare. Memorandumi synon nxitjen e koordinimit të veprimtarive të përbashkëta dhe ofrimit të kontributit në vendlindje të stomatologëve të cilët ushtrojnë profesionin në diasporë, me qëllim rritjen e standarteve profesionale. Nxitjen e politikave të "turizmit dentar" në Shqipëri për anëtarët e komuniteteve shqiptare në diasporë me





qëllim nxitjen e forcimit të lidhjeve me vendlindjen dhe politikat e turizmit në Shqipëri.

- ✓ Memorandum bashkëpunimi ndërmjet Agjencisë Kombëtare të Diasporës – Agjencia Kombëtare të Rinisë, datë 07.04.2021.

Qëllimi i këtij Memorandumi, është nxitja e bashkëpunimit midis Palëve, për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të të rinjve në Republikën e Shqipërisë dhe të rinjve shqiptarë në diasporë. Dhënien e mundësive të barabarta dhe garantimit të pjesëmarrjes të të rinjve në proceset politikëbërëse dhe vendimmarrëse në fushat e arsimit, kërkimit shkencor, politikave financiare, punësimit, vullnetarizmit, mbrojtjes e përfshirjes sociale, shëndetësisë, kulturës, sportit, mjedisit, turizmit, drejtësisë, punëve të brendshme e të jashtme, integritetit dhe të mbrojtjes, teknologjisë së informacionit, sipërmarrjes dhe në fusha të tjera që inkurajojnë zhvillimin e të rinjve; Memorandumi synon nxitjen e koordinimit të aktiviteteve apo veprimtarive të përbashkëta rinore me të rinjtë e komuniteteve shqiptare në diasporë me qëllim nxitjen e forcimit të lidhjeve me vendin e origjinës.

- ✓ Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Agjencisë Kombëtare të Diasporës dhe Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar “Për promovimin, nxitjen dhe zhvillimin e aktiviteteve sportive të pjesëtarëve të diasporës, me synim ruajtjen e traditave sportive kombëtare kulturore, si dhe promovimin e shtrirjes së tyre”, datë 07.07.2021.

Qëllimi i kësaj marrëveshje, është krijimi i urave të bashkëpunimit, midis Agjencisë Kombëtare të Diasporës dhe Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar, me qëllim promovimin, nxitjen dhe zhvillimin e aktiviteteve sportive të pjesëtarëve të diasporës, ruajtjen e traditave sportive kombëtare kulturore, si dhe promovimin e shtrirjes së tyre.

- ✓ Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Agjencisë Kombëtare të Diasporës dhe Institutit Alb-Shkenca “Për nxitjen e kërkim – zhvillimit dhe të bashkëpunimit me diasporën shkencore shqiptare”, datë 16.09.2021.

Qëllimi i kësaj marrëveshje, është realizimi i bashkëpunimit, midis Agjencisë Kombëtare të Diasporës dhe Instituti Alb-Shkenca me qëllim nxitjen e bashkëpunimit me Diasporën shkencore shqiptare në fushën e kërkim - zhvillimit,



organizimin e takimeve dhe konferencave shkencore, botimin e punimeve dhe studimeve shkencore.

- ✓ Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Agjencisë Kombëtare të Diasporës dhe Bashkisë Tiranë “Për promovimin e pjesëtarëve të diasporës dhe bashkërendimin për çështje të lidhura me diasporën” datë 18.10.2021.

Qëllimi i kësaj marrëveshje, është nxitja e organizimeve, aktiviteteve të përbashkëta brenda dhe jashtë vendit, promovimin e pjesëtarëve të diasporës në fushën e artit, kulturës, përfshirjen e të rinjve në projekte dedikuar inovacionit (ICT) e më gjerë, si dhe në nxitjen e vijimësisë së konsultimeve të përbashkëta dhe bashkëpunimit ndërmjet strukturës së posaçme për diasporën dhe migracionin, për administrimin e shërbimeve në nivel vendor dhe Agjencisë për çështje të lidhura me diasporën. Gjithashtu nëpërmjet këtij memorandumi synohet ngritja e Këshillit Rinor në Diasporë. Anëtarët e tij do të jenë pjesëtarë të diasporës me histori suksesi në fushën e artit, kulturës, sportit, të cilët gjatë karrierës së tyre kanë dhënë kontribut të çmuar në promovimin dhe zhvillimin e qytetit.

10. PUBLIKIME

10.1. BULETINI I MASAVE TË PLANIT TË VEPRIMIT¹

Në vitin 2021, Agjencia Kombëtare e Diasporës ka vijuar të publikojë buletin (cdo tre muaj) për zbatimin e masave të Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare të Diasporës. Buletini synon të informojë publikun e gjerë, anëtarët e Komisionit për Politikën e Jashtme pranë Kuvendit, anëtarët e Nënkomisionit për Diasporën dhe Migracionin, anëtarët e Këshillit Shtetëror të Diasporës dhe Anëtarët e Këshillit Koordinues të Diasporës dhe publikun e gjerë në angazhimin e çdo institucioni përgjegjës në zbatimin e masave të Planit të Veprimit të Strategjisë. Gjatë vitit 2021 u publikuan Buletini Nr. 1 (mars 2021) Buletini Nr. 2 (qershor 2021) dhe Buletini Nr. 3 (dhjetor 2021). Publikimi i buletineve tre mujorë shërben si një praktikë bazuar në parimin e transparencës dhe nxit llogaridhënien institucionale. Ai bën publike punën e Agjencisë Kombëtare të Diasporës përpara një komuniteti jo prezent në vendlindje, siç është diaspora shqiptare.

¹ <http://akd.gov.al/buletini-per-masat-e-planit-te-veprimit/>





10.2. REVISTA INFORMATIVE PËR BURSAT PËR DIASPORËN NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË²

Revista e bursave për Diasporën në Republikën e Shqipërisë është një botim i veçantë elektronik, i cili përmbledh aktet ligjore dhe nënligjore të miratuara lidhur me bursat për studentët e Diasporës në Republikën e Shqipërisë.

10.3. NEWSLETTER PËR DIASPORËN

“Newsletter e Diasporës” është një buletin informativ javor i cili pasqyron aktivitetet e institucioneve të Diasporës. Qëllimi i kësaj nisme është informimi i publikut të gjerë mbi ecurinë e praktikave që kanë lidhje me diasporën shqiptare.

10.4. MANUAL PËR KRIJIMIN E BAZËS TË TË DHËNAVE SHTETËRORE TË STUDENTËVE³

Manuali është një botim i veçantë elektronik, i cili përmbledh aktet rregulluese për krijimin e Bazës së të dhënave shtetërore të studentëve, të cilët studiojnë jashtë vendit, dhe shtetasve të huaj me origjinë shqiptare, të cilët përfitojnë bursa studimi nga Republika e Shqipërisë dhe shtetasve shqiptarë, të cilët kanë përfituar bursat e studimit, të cilat i ofrohen Shqipërisë nga shtete, organizata ndërkombëtare dhe jofitimprurëse në bazë të marrëveshjeve të nënshkruara apo dokumente të tjera ku Republika e Shqipërisë është palë.

11. RAPORTIMI I DREJTORISË SË FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Agjencia Kombëtare e Diasporës, për realizimin e buxhetit të shtetit të vitit 2021 është mbështetur në nevojat më të domosdoshme institucionale dhe zbatimin korrekt të detyrimeve që rrjedhin nga ligji nr. 115, datë 18.12.2017 “Për Krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës”, Strategjisë Kombëtare të Diasporës 2019-2025 dhe Planit të Veprimit.

² <https://online.fliphtml5.com/asggu/lkxa/#p=1>

³ <https://online.fliphtml5.com/asggu/ezzë/#p=1>





AGJENCIA KOMBËTARE E DIASPORËS


Ky raport përfshin periudhën Janar – Dhjetor 2021 dhe pasqyron funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës në kushtet e pandemisë covid-19.

Bazuar në Ligjin nr. Bazuar në Ligjin nr. 137/2020“Për buxhetin e vitit 2021”, Agjencisë Kombëtare të Diasporës për vitin 2021, i është akorduar fondi buxhetor prej **87,600,000(tetëdhjetë e shtatë milion e gjashtëqind mijë)lekë**, i detajuar si më poshtë:

– Shpenzime personeli(paga dhe sigurime shoqërore)	17,600,000 lekë;
– Shpenzime korrente (mallra dhe shërbime,bursa)	62,000,000 lekë;
– Shpenzime kapitale (investime)	8,000,000 lekë.

Gjithsej

87,600,000 lekë



Në vitin 2021 në kuadër të bashkëpunimit institucional dhe me miratimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë u realizua riallokimi i brendëshëm i fondeve buxhetore në zërin “shpenzime kapitale” në vlerën 8.000.000 lekë, duke e rritur kështu shpenzimet kapitale në vlerën 16.000.000(gjashtëmbëdhjetë milion) lekë. Ky riallokim u realizua brenda programit buxhetor “Shërbime për Diasporën”(grupi 87), nga Qendra e Botimeve për Diasporën tek Agjencia Kombëtare e Diasporës dhe si pasojë fondet e përgjithshme buxhetore të Agjencisë Kombëtare të Diasporës u rritën në vlerën **95.600.000(nëntëdhjetë e pesë milion e gjashtëqind mijë)lekë**.






Ndërsa me anë të Aktit Normativ nr.26, Datë 22.06.2021, “Për disa ndryshime në Ligjin nr. 137/2020“Për buxhetin e vitit 2021”, Agjencisë Kombëtare të Diasporës iu pakësuan fondet buxhetore në zërin “Shpenzime Korrente” (llogaria ekonomike 602) në vlerën 20,000,000 (njëzet milion)lekë.

Si pasojë vlerat përfundimtare të buxhetit për vitin 2021 rezultojnë si më poshtë:

– Shpenzime personeli(paga dhe sigurime)	17,600,000 lekë;
– Shpenzime korrente (mallra dhe shërbime,bursa)	42,000,000 lekë;
– Shpenzime kapitale (investime)	16,000,000 lekë.

Gjithsej
75,600,000 lekë

Buxheti 2021 pas ndryshimeve




11.1. Realizimi

Agjencia Kombëtare e Diasporës, referuar buxhetit të vitit 2021, ka zbatuar politikat e veta ekonomike, për një menaxhim sa më të mirë dhe me efektivitet të shpenzimeve buxhetore, duke planifikuar shpenzimet e kontraktuara si dhe shpenzimet e tjera, më të domosdoshme, në mbështetje të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”. Në përfundim të vitit buxhetor Janar-Dhjetor 2021, rezulton se shpenzimet faktike janë realizuar si më poshtë:


TABELA E BUXHETIT DHE REALIZIMI (PLAN-FAKT)

Llog.ek	Përshkrimi	Buxheti Plan 2021	Buxheti Fakt 2021	Buxheti i realizuar %
600	Shpenzime për Paga	15,500,000.00	12,413,473.00	80 %
601	Shpenzime për Sigurime Shoqërore & Shëndetësore	2,100,000.00	2,068,801.00	99 %
602	Shpenzime Korrente	42,000,000.00	33,161,356.46	79 %
231	Shpenzime Kapitale	16,000,000.00	14,913,600.00	93%
	Gjithsej	75,600,000.00	62,557,230.46	82%



11.1.1. Shpenzime për Fondin e pagave dhe sigurimeve (llogaria ekonomike 600,601)

Fondi i pagave dhe sigurimeve shoqërore e shëndetësore, u realizua në zbatim të strukturës organizative të miratuar. Gjatë kësaj periudhe numri mesatar i punonjësve u realizua deri në 13 punonjës, nga 15 punonjës të miratuar me Urdhrin Nr.111, Datë 10.09.2021 “Për miratimin e Strukturës së Organikës së Agjencisë Kombëtare të



Diasporës” e përbërë nga Drejtoria e Diasporës (Sektori i Diasporës dhe Sektori i Kulturës, Identitetit dhe Komunikimit), Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse si dhe Sektori i Projekteve.

Fondi i përgjithshëm i pagave dhe i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, për këtë periudhë është realizuar për numrin faktik të punonjësve, në vlerën 12,413,473.00 (dymbëdhjetë million e katërqind e trembëdhjetë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e tre) lekë ose 80 % e fondit të planifikuar për vitin 2021 dhe për kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore në vlerën 2,068,801.00 (dy milion e gjashtëdhjetë e tetë e tetëqind e një) lekë, ose 99 %, e planifikimit për periudhën respektive.

11.1.2. Shpenzimet Korrente (mallra dhe shërbime, llogaria ekonomike 602)

Për vitin 2021, fondi i shpenzime korrente është realizuar në vlerën 33,161,356.00 (tridhjetë e dy milion e tetëqind e pesëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e gjashtë dhjetë e shtatë) lekë ose 79% e fondit të planifikuar.

Në llogarinë ekonomike 602 “shpenzime korrente” për arsye të pandemisë, nuk u realizua dhënia e bursave për shtetasit e huaj me origjine shqiptare sipas VKM 447 dt 22.07.2021 “Për kriteret e dhenies së bursave për shtetasit e huaj me origjine shqiptare, për të studiuar në Republikën e Shqipërisë, nga Agjencia Kombëtare e Diasporës për vitin akademik 2021-2022”.

Agjencia Kombëtare e Diasporës në zbatim të dispozitave ligjore financiare në fuqi, gjatë kësaj periudhe, në realizimin e shpenzimeve korrente, është mbështetur në kërkesa të cilat lidhen me:

- Realizimin e shpenzimeve të detyrueshme ndaj shtetit, si detyrimet për taksa e tatime.
- Realizimin e shpenzimeve për blerje materiale dhe shërbimesh, sipas nevojave konkrete, për krijimin dhe përmirësimin e kushteve të punës në realizimin e një aktiviteti normal institucional. të tilla si blerje materiale kancelarike, shërbim printimi, botimi, honorare, shërbim përkthimi etj.



- Realizimin e shpenzimeve për udhëtime jashtë vendit, dieta, akomodim, materiale promocionale, të nevojshme për realizimin e aktiviteteve dhe takimeve në Diasporë sipas Programit vjetor të miratuar nga Këshilli Drejtues.

11.1.3. Shpenzime kapitale (llogaria ekonomike 231)

Fondi për Shpenzime Kapitale (llog.231) me vlerë 16,000,000(gjashtëmbëdhjetë million)lekë, është realizuar në vlerën 14,913,600 (katërmëdhjetë million e nëntëqind e trembëdhjetë mijë e gjashtëqind) lekë.

Llogaria ekonomike “Shpenzime kapitale” u prek në vlerën 14,913,600.00(katërmëdhjetë milion e nëntëqind e trembëdhjetë mijë e gjashtëqind) lekë, nëpërmjet realizimit të procedurës së prokurimit me objekt “Krijimi i bazës së të dhënave shtetërore” në zbatim të Vendimit nr.504, datë 24.06.2020 “Për krijimin e bazës të të dhënave shtetërore të studentëve të cilët studiojnë jashtë vendit, dhe shtetasve të huaj me origjinë shqiptare, të cilët përfitojnë bursa nga republika e shqipërisë”, zhvilluar nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, për llogari të Agjencisë Kombëtare të Diasporës.

Pjesa e mbetur e llog 231 “shpenzime kapitale” është në vlerën 1,086,400.00(një million e tetëdhjetë e gjashtëmijë e katërqind) lekë.

DREJTORIA E FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE (FUNKSIONIMI)

11.1.4. Financa

Gjatë kësaj periudhe sektori i financës ka evidentuar me përpikmëri nëpërmjet kontabilizimeve në ditarët përkatës (ditari i magazinës si dhe shpenzimeve të arkës dhe të bankës) të gjitha shpenzimet e kryera në valutë si edhe në lekë.

Në zbatim të ligjit për menaxhimin financiar si dhe udhëzimin në zbatim të tij dhe kontrollin, sektori i financës ka përgatitur të gjitha urdhër-shpenzimet në afatin e caktuar për faturat e paraqitura nga kryerja e prokurimeve publike, pagesat për pagat, honoraret dhe dietat e punonjësve. Janë përgatitur dhe likuiduar 173 urdhër shpenzime.



Janë përgatitur brenda afatit të gjitha listë pagesat për pagat si dhe listë pagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të punonjësve. Gjatë kësaj periudhe janë kryer pagesat e pagave të punonjësve nëpërmjet listë pagesave dhe urdhër shpenzimeve të gjeneruara nga sistemi HRMIS.

Bazuar në Udhëzimin nr.30 datë 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve”, në fund të vitit kryhet inventarizimi i aktiveve.

Janë përgatitur raportimet periodike për Ministrinë e Financave, rakordimet me Degën e Thesarit si dhe çdo informacion tjetër me karakter financiar.

11.1.5. Burime Njerëzore

Burimet njerëzore janë një faktor i rëndësishëm në realizimin e objektivave kryesorë institucionale. Në këtë kontekst, Agjencia Kombëtare e Diasporës ka patur si objektiv prioritar jo vetëm ngritjen e kapaciteteve të brendshme por dhe ruajtjen e një strukture organike që do ti mundësonte eficiencë në realizimin e misionit të saj. Menaxhimi i Burimeve Njerëzore në Agjenci është i orientuar drejt administrimit me korrektësi të dosjeve të personelit, si dhe vlerësimit vjetor të performancës në punë për çdo punonjës, në kohë dhe në përputhje me rregullat administrative përkatëse si dhe identifikimit të nevojave të personelit për përmirësimin e aftësive profesionale të tyre nëpërmjet realizimit të trajnimeve në përshtatje me nevojat profesionale të vendit të punës me qëllim përballimin e sfidave të ndryshme në të ardhmen.

Janë zhvilluar trajnime të ndryshme për nëpunësit e Agjencisë Kombëtare të Diasporës të organizuara nga Shoqëria Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ), Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA), Organizata Ndërkombëtare e Migracionit (IOM), Ministria e Brendshme si dhe Universiteti i Matrihtit.

Temat e trajnimeve kanë qenë gjithëpërfshirëse, si psh përditësimi dhe zbatimi i Ligjit të ri të Prokurimit Publik specifikisht “Kriteret e kualifikimit dhe të përzgjedhjes së ofertave fituese në procedurat e prokurimit publik”, “Konsultimi Publik”, “Migration Governance and Migration Development with the focus on Engagement of Diaspora, and Migration Data”, “Project Cycle Management”, “Data Collection, Interpretation and Analysis” pjesë e projektit “Diaspora and Return Migrants engaged in Local Strategic Development Plans at the Municipal Level”, “Forcimi i kapaciteteve



institucionale për qeverisjen e migracionit në Shqipëri” Gjithashtu është zhvilluar edhe Programi i Diplomës së Menaxhimit të Migracionit (MMDP) i cili është një program për ngritjen e kapaciteteve dhe është financuar nga Bashkimi Evropian (BE) përmes Institucionit të Partneritetit të Migracionit (MPF) të Qendrës Ndërkombëtare për Zhvillimin e Politikave të Migracionit (ICMPD) dhe u drejtohet profesionistëve qeveritarë nga vendet e fqinjësisë së BE-së, Partneritetit Lindor, Afrikës dhe Ballkanit Perëndimor. të cilët punojnë në fushën e migracionit.

Për të mundësuar realizimin me eficiencë të objektivave dhe misionit të institucionit, në bashkëpunim me DAP-in, në cilësinë e njësisë përgjegjëse për institucionet e administratës shtetërore janë ndjekur procedurat për plotësimin e vendeve vakante.

Gjithashtu si rezultat i procesit të ristrukturimit në të cilin ka kaluar Agjencia Kombëtare e Diasporës dhe miratimit të strukturës së re sipas Urdhër Nr.111, datë 10.09.2020 “Për miratimin e Strukturës së Organikës së Agjencisë Kombëtare të Diasporës” numri i punonjësve në vitin 2021 ka qenë 16 punonjës.

Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, në përputhje me Ligjin “Për nëpunësin civil”, ka realizuar përgatitjen e dosjeve të personelit, si dhe raportime periodike në kuadër të menaxhimit të burimeve njerëzore.

Gjatë këtij viti në përputhje me detyrimet e përcaktuara nga ligji “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe nëpunësve publik”, autoriteti përgjegjës ka ndjekur depozitimin në kohë të formularit të Deklarimit të Interesave Privatë Periodik/Vjetor për subjektet që kanë detyrim deklarimi.

11.1.6. Protokolli

Në bazë të ligjit "Për Arkivat", është bërë pritja e shkresave të hyra në institucionin, duke i vendosur kartelën shoqëruese, numrat e protokollit dhe përcjelljen e tyre drejt drejtuesit të Institucionit, i cili bën shpërndarjen e shkresave sipas drejtorive përkatëse. Është kryer procedura ligjore për shkresat dalëse të institucionit tonë, duke verifikuar fillimisht plotësimin e kushteve dhe parametrave që përcakton ligji ynë në pjesën e ndërtimit të shkresave, vendosjen e numrit të protokollit, dërgimit të tyre drejt drejtuesit



të Institucionit për firmosje dhe vulosje dhe së fundmi klasifikimin e dokumenteve sipas strukturave organizative të institucionit.

11.1.7. Magazina

Në hyrjen dhe shpërndarjen e artikujve nga magazina është ndjekur procedura ligjore duke bërë evidentimet e nevojshme në fletë-hyrjet, fletë-daljet dhe janë bërë pasqyrimet në Librin e Magazinës për sasi të artikujve të dalë nga magazina dhe gjendjen e tyre të mbetur në magazinë.

Në fund të vitit është kryer inventarizimi i aktiveve bazuar në Udhëzimin nr.30 datë 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve”.

11.1.8. Prokurime

Në zbatim të planit për shpenzime, AKD ka hartuar e zbatuar regjistrin e prokurimeve, i cili gjatë vitit 2021 është realizuar nëpërmjet procedurave të prokurimit me vlera të vogla, si dhe blerjeve nën 100.000 lekë pa tvsh. Bazuar në ligjin Nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin Publik”, të ndryshuar, VKM nr.28/2020 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe udhëzimeve përkatëse në periudhën Janar-Dhjetor janë kryer dhe realizuar me sukses procedurat e prokurimit publik me objekt të ndryshëm prokurimi duke përfshirë “Blerje e shërbimit foni ndricim per aktivitete”, “artikuj promocionalë”, “blerje materiale kancelarike”, “shërbim përkthimi”, “blerje biletash ndërkombëtare në sistemin dinamik”, shërbim transporti, etj.

Janë krijuar në sistemin elektronik të APP-së gjithsej 12 procedura prokurimi, nga të cilat 2 janë anuluar dhe janë rihedhur për arsye se asnjë nga operatorët ekonomikë nuk përmbushte kërkesat e Autoritetit Kontraktor, ndërsa 10 procedura prokurimi u realizuan me sukses.



12. PLANIFIKIMI I AKTIVITETEVE PËR VITIN 2022

12.1. Programi vjetor i AKD-së për vitin 2022

Agjencia Kombëtare e Diasporës në funksion të zbatimit të misionit të saj për nxitjen dhe konsolidimin e bashkëpunimit institucional, me qëllim zbatimin e një qasjeje gjithëpërfshirëse për angazhimin e Diasporës në zhvillimin ekonomik, politik, social dhe kulturor të Shqipërisë, në bashkëpunim me Ministrinë e Evropës dhe Punëve të Jashtme, Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve, Ministrinë e Kulturës, Ministër i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, për vitin 2022 do të vazhdojë zgjerimin e programeve të mësimin të gjuhës shqipe dhe aktivitetet kulturore për komunitetet shqiptare në Ukrainë, Itali, Greqi, Mbretëri e Bashkuar, Shtete të Bashkuara të Amerikës, Kroaci, etj. Ato janë vlerësuar për të krijuar dhe forcuar urën e komunikimit midis Republikës së Shqipërisë dhe Diasporës Shqiptare, duke përçarur pasurinë kulturore të shtetit amë.

Ky program përmban aktivitetet e parashikuara si më poshtë:

12.1.1. Aktiviteti vjetor me rastin e Ditës së Diasporës.

Në datën 18 Dhjetor është Dita e Diasporës në të cilën do të realizohet takimi zyrtar i Këshillit Koordinues të Diasporës. Gjatë kësaj dite do të ketë evente të ndryshme të cilat do të organizohen në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse shtetërore për diasporën.

12.1.2. Takimi i Mjekësisë në Diasporë.

Në kuadër të Programit vjetor do të zhvillohet në Tiranë takimi i mjekëve të Diasporës në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale. Ky takim synon të krijojë rrjetëzimin e mjekëve, infermierëve shqiptarë kudo në botë dhe kërkon të kthehet në një takim të përvitshëm ku profesionistët në fushën e mjekësisë do të mbledhen dhe shpalosin idetë e tyre, propozimet për përmirësimin e sistemit të kujdesit shëndetësor në vend si dhe rishikimin e kthimit në Shqipëri përmes politikave shtetërore

12.1.3. Takimi i Juristëve në Diasporë.



Agjencia Kombëtare e Diasporës në bashkëpunim me Ministrinë së Drejtësisë do të organizojë takimin e juristëve në diasporë. Takimi synon të mbledhë juristë, avokatë, profesionistë të së drejtës që operojnë jashtë vendit me qëllim angazhimin e tyre edhe në hartimin e paketave ligjore vendase si dhe “përthithjen” e elementëve më cilësorë të cilët mund të kontribuojnë në kuadër të reformës në drejtësi.

12.1.4. Programi vjetor për organizimin e shkollës verore “Jam shqiptar”.

“Programi jam shqiptar” me shkollën verore Duke u menduar si një aktivitet që do të ketë vazhdimësi dhe vitet e tjera do të programohet përafërsisht për fëmijë të diasporës shqiptare. Programi parashikon qëndrimin gjatë pushimeve verore për një periudhë kohore 2-javorë në një nga qytetet bregdetare të Shqipërisë.

12.1.5. Programi për ofrimin e bursave për studentët e huaj me origjinë Shqiptare

Për vitin akademik 2022, AKD do të vazhdojë të financojë bursa për studentët e huaj me origjinë shqiptare për të studiuar në Republikën e Shqipërisë në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.447, Datë 22.7.2021 “Për kriteret e dhënies së bursave për shtetasit e huaj me origjinë shqiptare, për të studiuar në Republikën e Shqipërisë, nga Agjencia Kombëtare e Diasporës për vitin akademik 2021-2022”. Në këtë kuadër Agjencia Kombëtare e Diasporës do të kryejë dhe pagesat e mësuesve të nevojshëm për mësimin e gjuhës shqipe në vitin e parë të studimeve për shtetasit e huaj me origjinë shqiptare të cilët përfitojnë bursa studimi nga Republika e Shqipërisë për vitin akademik 2021.

12.1.6. Programi vjetor për Komunitetet Shqiptare në Mbretëri e Bashkuar, Itali, Greqi, Turqi, Bullgari, Bruksel, Ukrainë, SH.B.A, Kroaci etj.

Ky program konsiston në shpenzime për aktivitete në lidhje me ruajtjen promovimin e kulturës shqiptare në fushën e kulinarisë, shpërndarjen e librave në gjuhën shqipe, kostumeve popullore si dhe shpenzime plotësuese për realizimin e aktiviteteve .

Këto aktivitete synojnë të forcojnë komunikimin e vendosur gjatë aktiviteteve të zhvilluara gjatë vititparardhës, të Shqipërisë me komunitetet shqiptare në diasporë.



**AGJENCIA
KOMBËTARE
E DIASPORËS**

Gjithashtu duke patur parasysh kërkesat në rritje për mësimin e gjuhës shqipe, këngëve dhe valleve popullore si dhe ndjeshmërinë e politikës shqiptare ndaj diasporës, për të arritur këtë qëllim në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit do të vazhdojnë të organizohen kurse mësimi të gjuhës shqipe për fëmijët dhe të rriturit. Në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës dhe Teatrin Kombëtar të Operas dhe Baletit të vazhdojnë të organizohen kurse mësimi të valleve dhe këngëve popullore për të rinjtë dhe të rejat në krahinat me komunitete shqiptare.

Shenim: Agjencia Kombëtare e Diasporës, për parashikimin e aktivitetiteve të vitit 2022 është mbështetur në nevojat më të domosdoshme institucionale dhe zbatimin korrekt të detyrimeve që rrjedhin nga ligji nr. 115, datë 18.12.2017 “Për Krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës”, i ndryshuar dhe Strategjisë Kombëtare të Diasporës dhe Planit të Veprimit 2021-2025.





SFIDA NË TË ARDHMEN

Për vitin 2022, Agjencia Kombëtare e Diasporës, do të punojë ngushtësisht me diasporën shqiptare kudo në botë, si dhe me shoqata e organizata përfaqësuese të interesave të tyre, për promovimin e vlerave kombëtare, identitetit dhe trashëgimisë kulturore, por dhe në promovimin e diversitetit kulturor të diasporës tonë të cilët janë mbartës të kulturës jo vetëm të vendit të origjinës por dhe të vendit pritës, promovimin e pjesëtarëve të diasporës dhe do zgjerojë shtrirjen e saj kudo në botë ku ka prezencë të diasporës shqiptare nëpërmjet forcimit të lidhjeve dhe nëpërmjet prezantimit të kulturës shqiptare në gjeneratën e re në diasporë.

Gjatë vitit 2022, synohet të krijohet Këshilli Koordinues Rinor i Diasporës, me qëllim zhvillimin dhe konsolidimin e politikave të shtetit shqiptar për promovimin e të rinjve profesionistë të diasporës në Shqipëri, nxitjen e pjesëmarrjes të të rinjve në proceset politikëbërëse dhe vendimmarrëse në fushat e arsimit, kërkimit shkencor, politikave financiare, punësimit, vullnetarizmit, mbrojtjes e përfshirjes sociale, shëndetësisë, kulturës, sportit, mjedisit, turizmit, drejtësisë, punëve të brendshme e të jashtme, integritit dhe të mbrojtjes, teknologjisë së informacionit, sipërmarrjes dhe në fusha të tjera që inkurajojnë zhvillimin e të rinjve si dhe hartimin e nismave dhe projekteve rinore brenda dhe jashtë vendit.

Do të vijohet puna e filluar në drejtim të nxitjes së kërkimit shkencor dhe inovacionit nga pjesëtarë të diasporës.

Sa i takon Fenomenit të “rrjedhjes së trurit” që përfshin akademikët, personat e kualifikuar në fusha të ndryshme, si edhe një numër të konsiderueshëm studentësh shqiptarë që studiojnë në universitete të huaja, Agjencia në një linjë me politikën e Qeverisë së Shqipërisë do të synojë kthimin vullnetar të emigrantëve të kualifikuar, të përhershëm ose të përkohshëm, nëpërmjet qëndrimeve afat-shkurtra për qëllime konsultimi, mësimdhënie apo trajnimi. Kësaj do t’i shërbejë edhe evidentimi i të gjithë kapaciteteve intelektuale që ndodhen jashtë vendit si dhe do nxisë përfaqësuesit e brezit të ri të talentuar jashtë vendit të tërhiqen drejt një karriere profesionale në vend.





PËRMBYLLJE

Raporti i vitit 2021 është dokumenti gjithëpërfshirës i punës dhe veprimtarisë së Agjencisë Kombëtare të Diasporës.

Përfundimi i këtij viti, nuk mund të ishte i tillë pa angazhimin e çmueshëm të stafit të Agjencisë, partneritetin e të gjithë aktorëve publik dhe privat, vendas e ndërkombëtar.

Për vitin 2021 vendosim theksin në domosdoshmërinë e realizimit të detyrës me përkushtim, me synim rritjen e bashkëpunimit me Diasporën dhe përfshirjen e saj aktive në këshillim për politikën e brendshme të Qeverisë Shqiptare dhe realizimin e programeve dhe projekteve për forcimin e rolit të saj nëpër botë.

